

BULETINI I ANKESAVE
JANAR – QERSHOR 2026

HYRJE

Ky është Buletini i **20-të** i Këshillit të Ankesave, në përmbajtje të të cilit pasqyrohen ankesat e trajtuara gjatë periudhës **janar–qershor 2026**, si dhe problematikat kryesore të evidentuara nga shqyrtimi i tyre. Gjatë kësaj periudhe, Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive ka administruar **194 ankesa**, me objekte dhe problematika të ndryshme që lidhen me përmbajtjet e transmetuara në mediat audiovizive.

Nga shqyrtimi i tyre rezulton se përmbajtjet mediatike vijojnë të paraqesin problematika sa i takon respektimit të **të drejtave të njeriut dhe standardeve etike e profesionale të transmetimit**, kryesisht në lidhje me cenimin e imazhit, jetës private dhe dinjitetit të individit, mbrojtjen e të dhënave personale, të drejtat e fëmijëve, përdorimin e gjuhës fyese apo diskriminuese, si dhe etikën në komunikim. Rastet e administruara evidentojnë gjithashtu problematika që lidhen me **saktësinë dhe verifikimin e informacionit, balancimin e raportimit, të drejtën e përgjigjes dhe përgjegjësinë editoriale** në trajtimin e çështjeve me interes publik.

Një vëmendje e veçantë gjatë kësaj periudhe i është kushtuar **mbrojtjes së fëmijëve dhe personave të përfshirë në ngjarje të ndjeshme**, veçanërisht shmangies së identifikimit të drejtpërdrejtë apo të tërthortë të tyre. Në raste të tilla, ndërhyrja e Këshillit nuk është kufizuar vetëm në vlerësimin e përmbajtjes së transmetuar, por ka synuar edhe orientimin e mediave drejt përdorimit të masave më efektive të anonimizimit, një gjuhe të përgjegjshme dhe shmangies së trajtimit sensacionalist.

Të dhënat tregojnë se **shumica dërrmuese e ankesave vazhdojnë të paraqiten nga qytetarët**, çka konfirmon rolin e Këshillit të Ankesave si një mekanizëm i drejtpërdrejtë dhe i aksesueshëm për mbrojtjen e të drejtave të individëve në fushën e mediave audiovizive. Përmbajtja e ankesave dëshmon njëkohësisht një ndjeshmëri në rritje të publikut jo vetëm ndaj përmbajtjeve të transmetuara në ekran, por edhe ndaj **vijimësisë së tyre në platformat online të vetë subjekteve audiovizive**, veçanërisht kur ato cenojnë privatësinë, imazhin apo reputacionin e individëve.

Nga pikëpamja e **administrimit dhe vendimmarrjes**, qëndrimet e Këshillit të Ankesave konsistojnë kryesisht në **tërheqje vëmendjeje, në 16.5% të rasteve; thirrje sensibilizuese, në 1.0%; dhe sanksion financiar (gjobë), në 0.5% të rasteve**. Ndërkohë, **15.5% e ankesave kanë rezultuar jashtë juridiksionit**. Pjesa tjetër është administruar përmes procedurave të tjera të parashikuara në legjislacion dhe në praktikën e Këshillit, duke përfshirë shqyrtimin administrativ, kërkesat për informacion dhe sqarime, kërkesat për paraqitjen e pretendimeve nga subjektet audiovizive, verifikimin e materialeve të transmetuara, komunikimin me palët dhe mbylljen e çështjeve pas vlerësimit të rrethanave konkrete.

Praktika e këtij gjashtëmujori evidenton se **jo çdo përmbajtje e kundërshtuar nga ankuesit përbën domosdoshmërisht shkelje të kuadrit ligjor apo të Kodit të Transmetimit**. Në shqyrtimin e rasteve, Këshilli ka vlerësuar në mënyrë të balancuar lirinë editoriale dhe lirinë e shprehjes përkundërt detyrimit të medias për respektimin e dinjitetit, privatësisë, paanshmërisë dhe saktësisë së informacionit. Në disa raste është konstatuar se media kishte garantuar paraqitjen e qëndrimeve të palëve, kishte ndërhyrë në mënyrë të përshtatshme gjatë transmetimit ose kishte korrigjuar informacionin, duke mos krijuar kushtet për marrjen e masave administrative.

Nga ana tjetër, rastet e trajtuara gjatë kësaj periudhe tregojnë një ndërthurje gjithnjë e më të madhe ndërmjet **transmetimit tradicional audioviziv dhe shpërndarjes së njëjtës përmbajtje në mjedisin online**. Këshilli ka vlerësuar në raste konkrete jo vetëm përmbajtjen e transmetuar, por edhe mënyrën e prezantimit të saj në platformat e subjekteve audiovizive, përfshirë titujt promovues dhe materialet e publikuara online, duke rekomanduar, kur ka qenë e nevojshme, editimin, korrigjimin apo heqjen e përmbajtjeve që nuk respektojnë standardet profesionale dhe etike.

Në të njëjtën kohë, një pjesë e ankesave ka evidentuar edhe **kufijtë e juridiksionit të Autoritetit**, veçanërisht në raport me portalet informative, rrjetet sociale dhe platformat e shpërndarjes së videove që nuk ndodhen nën juridiksionin efektiv të Republikës së Shqipërisë. Këto raste dëshmojnë se zhvillimi i mënyrave të shpërndarjes dhe konsumimit të përmbajtjeve audiovizive po krijon problematika të reja edhe për mekanizmat tradicionalë të mbrojtjes së publikut.

Në tërësi, të dhënat e **gjashtëmujorit të parë të vitit 2026** tregojnë vazhdimësinë e rolit aktiv të Këshillit të Ankesave në garantimin e respektimit të standardeve etike dhe ligjore në mediat audiovizive. Rastet e trajtuara evidentojnë nevojën për vëmendje të vazhdueshme ndaj **saktësisë dhe verifikimit të informacionit, mbrojtjes së privatësisë, imazhit dhe dinjitetit të individit, të drejtës së përgjigjes, etikës në komunikim dhe mbrojtjes së fëmijëve**, por edhe ndaj mënyrës se si përmbajtjet audiovizive vijnë në qarkullojnë dhe të ndikojnë publikun përmes platformave online. Në këtë kuptim, veprimtaria e Këshillit shërben jo vetëm për adresimin e rasteve konkrete, por edhe për evidentimin e problematikave të përsëritura dhe orientimin e subjekteve audiovizive drejt një zbatimi më të qëndrueshëm të standardeve ligjore, etike dhe profesionale.

ANKESA ME OBJEKT “CENIMIN E RREGULLAVE TË ETIKËS DHE DINJITETIT”

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
Gj.K	MCN TV	Xhadat	15.01.2026

1.Objekti i Ankesës

Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) i mbërriti për shqyrtim një ankesë me objekt pretendimin për: *“shkelje të etikës mediatike, cenim të privatësisë dhe pengim/cenim të ushtrimit normal të veprimtarisë profesionale noteriale”*.

2.Administrimi i Ankesës

Pas shqyrtimit të ankesës, ankuesit ju bë me dije se në përputhje me nenin 2 të ligjit nr. 97/2013 *“Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, juridiksioni i Autoritetit të Mediave Audiovizive shtrihet mbi *“transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre, si dhe për shërbimet e platformave të shpërndarjes së videove”*, pra mbi përmbajtjen audiovizive të transmetuar dhe respektimin e standardeve etiko-ligjore në transmetim.

Veprimet e pretenduara që lidhen me mënyrën e raportimit në terren, vendosjen e kamerave në ambient publik, ndërveprimin me persona fizikë apo ndikimin e mundshëm në ushtrimin e veprimtarisë profesionale, përbëjnë çështje që mund të bien në juridiksionin e organeve të tjera kompetente (si organet e rendit, gjyqësorët, apo autoritetet për mbrojtjen e të dhënave personale), por nuk përfshihen drejtpërdrejt në kompetencën rregullatore të AMA-s, për sa kohë nuk kemi të bëjmë me një përmbajtje audiovizive të transmetuar, e cila cenon standardet e parashikuara nga ligji dhe Kodi i Transmetimit.

3.Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Për rrjedhojë, Këshilli i Ankesave nuk mund të vijonte me shqyrtimin e kësaj ankesë në kuadër të kompetencave të përcaktuara nga ligji nr. 97/2013.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
B.B	Media Portale		19.01.2026

1.Objekti i Ankesës

Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) i mbërriti për shqyrtim ankesë me anë të së cilës shprehet shqetësimi lidhur me mënyrën e raportimit mediatik të një rasti familjar të ndjeshëm, duke pretenduar publikim informacioni të pavërtetë, diskriminim të nënës, cenim të dinjitetit njerëzor dhe ekspozim publik të familjes dhe fëmijëve të saj.

2.Administrimi i Ankesës

Në këtë kuadër, Autoriteti vlerësoi të nevojshme të sqaronte, se në bazë të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, AMA nuk ushtron kompetenca për verifikimin e faktit apo të vërtetësisë materiale të ngjarjeve të raportuara, si dhe nuk përcakton përgjegjësi penale apo civile si organet e drejtësisë.

3.Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në përfundim, ankueses ju bë me dije se Autoriteti i Mediave Audiovizive do të vijojë monitorimin e përmbajtjeve audiovizive dhe, në rast se nga shqyrtimi i rasteve konkrete konstatohet shkelje e dispozitave ligjore dhe nënligjore në fuqi nga subjektet që bien në juridiksionin e tij, do të ushtrojë kompetencat përkishtetëse administrative, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
R.M	TV Klan	X factor kids	19.01.2026

1.Objekti i Ankesës

Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) i mbërriti për shqyrtim ankesë e shtetasit R.M të paraqitur përmes postës elektronike (info@ama.gov.al) më datë 19.01.2026, me objekt: Emisionin "X Faktor Kids" transmetura në Tv Klan më datë 16.01.2026.

2.Administrimi i Ankesës

Ankuesi pretendonte se në emision kishte pasur: “veshje të papërshtatshme të moderatores së emisionit, znj. A.V, si dhe të anëtares së jurisë, znj. O.M”,

Në zbatim të procedurave të shqyrtimit të ankesës dhe në përputhje me pikën 2 të nenit 5 të rregullores “Mbi procedurat për shqyrtimin e ankesave nga Këshilli i Ankesave dhe të drejtës së përgjigjes”, Këshilli i Ankesave, me shkresën nr. 570 prot., datë 12.02.2026, i kishte dërguar ofruesit të shërbimit mediatik audioviziv “TV Klan” kërkesën për “Paraqitje Pretendimesh”.

Në përgjigje të kësaj shkrese, “TV Klan”, me shkresën nr. 570/1prot., datë 24.02.2026, kishte paraqitur pretendimet e veta, duke theksuar se: “Programi X Factor Kids ishte një format televiziv ndërkombëtar i konceptuar si spektakël muzikor që transmetohet në orarin prime time.

3.Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pas administrimit të ankesës, shqyrtimit të materialit audioviziv dhe të pretendimeve të paraqitura nga ofruesi i shërbimit mediatik audioviziv, Këshilli i Ankesave i solli në vëmendje “TV Klan” nevojën për të treguar kujdes në paraqitjen dhe veshjen e moderatores dhe të pjesëmarrësve në programin “X Factor Kids”, në mënyrë që ajo të jetë e përshtatshme me natyrën dhe formatin e programit, në të cilin në qendër ishin fëmijët.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
C.B	Syri Tv	Plug	20.01.2026

1.Objekti i Ankesës

C.B nisi një ankesë me pretendimin se emisioni “Plug”, transmetuar në Syri TV, ishte një “investigim” si një sulm i anshëm dhe i egër ndaj tij. Dhe se kjo palë nuk ishte as e pranishme në studio, 90% e shpifjeve të përsëritura në këtë emision ishin transmetuar në programin “Plug” dhe “Task Forcë” të datave 29 nëntor 2023, për të cilin kishit reaguar”. Ndaj kërkon nga Autoriteti i Mediave Audiovizive dënimin e OSHMA-së “Syri TV”, me masa ndëshkuese si dhe heqjen nga rrjetet sociale dhe faqja web e emisionit.

2.Administrimi i Ankesës

Në kuadrin e administrimit të ankesës së sipërpërmendur, Këshilli i Ankesave:

1. pas verifikimit të faktit, bazuar në nenin 51 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, rregulloren “Mbi procedurat për shqyrtimin e ankesave nga Këshilli i Ankesave dhe të drejtës së përgjigjes” si edhe udhëzimin “Mbi procedurat e trajtimit të ankesave nga Ofruesit e Shërbimit Mediatik Audioviziv”, me shkresën nr.265/1 prot., datë 02.02.2026, i kërkoi Bordit të Shqyrtimit të Ankesave të televizionit “Syri TV”, paraqitjen e pretendimeve lidhur me ankesën e sipërcituar. Në kthim përgjigjen e tyre, nr.11, prot., 10.02.2026, protokolluar me tonën nr. 265/2 datë 10.02.2026, OSHMA-ja, bëri me dije se: “SPAK bazuar në dokumentacionin dhe faktet e publikuara gjatë emisionit “Plug” kishte regjistruar kishtellëzimin penal me Nr.14/2024 dhe prej dy vitesh po kryen hetime të thelluara”.

Nga shqyrtimi i përmbajtjeve audiozive, emisioni “Plug”, transmetuar në televizionin “Syri TV” në datat 24 & 27.12.2025 në oraret 21:30 & 17:00, Këshilli i Ankesave evidentoi se:

- Referuar pretendimit tuaj se “90% e shpifjeve të përsëritura në këtë emision ishin transmetuar në programin “Plug” dhe “Task Forcë” të datave 29 nëntor 2023, për të cilin kishit reaguar dhe SYRI TV i kishte injoruar”, emisioni argumenton se rikthimi i trajtimit të çështjes lidhet me zhvillime të reja të pretenduara në kuadër të hetimeve nga organet e drejtësisë.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Për rrjedhojë, Këshilli i Ankesave, nuk konstatoi shmangie nga ligji nr.97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
C.B	Syri Tv	Kafe shqeto	20.01.2026

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) mori një ankesë nga Z. C.B me objekt emisionin “Kafe shqeto” transmetuar në televizionin “Syri TV”. Ankuesi pretendon se

në emisionin “Kafe shqeto”, transmetuar në datat 25.12.2025 & 28.12.2025, “duke u paraqitur në formë interviste në studio, u zhvillua një sulm i anshëm dhe i egër ndaj z. C.B, nga ana e drejtuesit të emisionit ndërsa i ftuari në studio, J.Ma, në mënyrë të përsëritur përdori gjuhë urrejtje, shpifëse, diskriminuese dhe cenuese të dinjitetit njerëzor pa shkishtektuar asnjë reagim nga moderatori”.

2.Administrimi i Ankesës

Në kuadrin e administrimit të ankesës së sipërpërmendur, Këshilli i Ankesave:

Në kuadër të administrimit të ankesës si dhe referuar nenit 51 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat për shqyrtimin e ankesave nga Këshilli i Ankesave dhe të drejtës së përgjigjes”, si dhe udhëzimit “Mbi procedurat e trajtimit të ankesave nga Ofruesit e Shërbimit Mediatik Audioviziv”, Këshilli i Ankesave kërkon nga Bordi i Shqyrtimit të Ankesave pranë televizionit tuaj paraqitjen e pretendimeve lidhur me ankesën e sipërcituar.

3.Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Nga shqyrtimi i përmbajtjeve audiozive, emisioni “Kafe Shqeto”, transmetuar në televizionin “Syri TV” në datat 25.12.2025 & 28.12.2025 ora 07:09:30, Këshilli i Ankesave evidentoi se:

- Emisioni “Kafe shqeto”, transmetuar në televizionin “Syri TV”, më datë 25 dhjetor 2025, ora 07:00-09:30 fillimisht nis me mendimet dhe komentet e qytetarëve, pas transmetimit të emisionit “Plug”, i cili pretendon se ka publikuar pjesë të dosjes së SPAK, referuar ngjarjeve të aktualitetit.
- Më tej, moderatori z.F.Q sqaron se nisur nga hetimet e SPAK, ka ftuar z.J.M për të vazhduar sqarimet lidhur me këtë pronë, por se media “Syri TV” është e hapur edhe nëse vetë z.B do të vij dhe të japë pretendimet e tij.
- Lidhur me akuzat e z.J.M, gjatë emisionit evidentohet fakti se palët z.M dhe B janë në proces gjyqësor, por përtej këtyre deklaratave, gjatë shqyrtimit të përmbajtjes audiovizive u evidentua se kishte patur etiketime fyese dhe në cënim të imazhit dhe dinjitetit njerëzor, për të cilat moderatori nuk kishte reaguar mjaftueshëm.

Në këtë kuadër, medias ju evidentu fakti se se liria e shprehjes nuk është absolute dhe ajo mund të kufizohet, sidomos kur ka përmbajtje të një gjuhe të papërshtatshme, që mund të nxisin urrejtje ose qëndrime që çenojnë integritetin dhe dinjitetin e njeriut.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
K.L	TV Klan		04.02.2026

1.Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive i mbërriti për shqyrtim ankesë e cila pretendonte, se një shtetase turke në televizionin “Klan” kishte përdorur fjalën “Arnaut” për të përshëndetur shqiptar, në formë fyerje.

2.Administrimi i Ankesës

Pas administrimit të ankesës , Këshilli i Ankesave në (AMA) Autoriteti i Mediave Audiovizive bëri kërkime për prejardhjen dhe kuptimin e fjalës “Arnaut”. Nga verifikimet tona na rezultoi se fjala Arnaut ishte etnonimi që përdorin turqit për shqiptarët. Ky emërim e kishte prejardhjen nga fjala greke arvanit, i cili ishte etnonimi i vjetër me të cilin grekët thërrisnin shqiptarët. Turqit e huazuan emërimin e tyre për shqiptarët nga grekët mesjetarë.

3.Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pra, pas këtij verifikimi ankuesja u informua se nuk kemi të bëjmë me një shkelje ligjore dhe për rrjedhojë nuk mund të merreshin masa administrative ndaj subjektit audioviziv “TV Klan”.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
I.J	TV Klan	Stop	05.11.02.2026

1.Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) i mbërriti për shqyrtim ankesë me objekt një material të transmetuar në emisionin “Stop” më datë 2 shkurt 2026, në televizionin “Klan”.

Në kuadër të administrimit të ankesës se shtetasit I.J pretendonte se: “Në emisionin “Stop” në TV Klan të datës 2 shkurt 2026 ishte trasmetuar një material audioviziv ku ishte cënuar integriteti duke publikuar informacion të rremë”. Ankuesja kërkonte nga “TV Klan” përgënjeshttrimin e lajmit dhe fshirjen e tij nga interneti”.

2.Administrimi i Ankesës

Pas verifikimit të materialit audioviziv për të cilin ankohej, Këshilli i Ankesave konstatoi se nuk kishte shkelje të ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nuk kishte shkelje të Kodit të Transmetimit.

Moderatorët dhe gazetarja e emisionit “Stop” që kishte trajtuar çështjen, kishte respektuar rregullat e nevojshme për një material informues, të paanshëm dhe shterues. Në materialin audioviziv përveç prononcimit të palëve, (ku ankueses i ishte dhënë mundësia të shprehë variantin e saj), ishin pyetur dhe ekspertë të çështjeve noteriale dhe ligjore, të cilët kishtenë folur në parim se si duhet të trajtohet një rast i tillë. Ata kishin dhënë dhe ide se si mund të përmirësohet legjislacioni për të zgjidhur sa më shpejt dhe më mirë çështje të ngjashme.

3.Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Ankueses ju sqaru se Këshilli i Ankesave në AMA kishte si objekt të punës, sjelljen e medias audiovizive duke u mbështetur gjithmonë në ligjin për mediat dhe jo objektin e konfliktit mes palëve, që ishte kompetencë ekskluzive e sistemit të drejtësisë.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
E. N	Top-Channel	Për'puthen	24.02.2026

1. Objekti i Ankesës

Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive i mbërriti për shqyrtim ankesë nga shtetasja E. N me objekt programin “Përputhen”, transmetuar në televizionin “Top Channel”. Kjo shtetase ankohej për pamjet e transmetuara në emisionin “Përputhen”, konkretisht për përmbajtjen e linkut që na vendosi në dispozicion.

2.Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pas administrimit të ankesës, Këshilli i Ankesave konstatoi se televizioni “Top Channel” kishte marrë masat e duhura përmes teknikave televizive për të mos transmetuar fjalorin e papërshtatshëm që u prodhua në program. Rjedhimisht ankuesja u informua se Këshilli i Ankesave nuk konstatoi shkelje të ligjit 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Kodit të Transmetimit.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
D.J	Ora News Top Channel EuroNewsAlbania A2CNN Gazeta Tema Shqiptarja.com	Lajme	26.03.2026

1.Objekti i Ankesës

D.V i nisi një kërkesë Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive me objekt *“refuzimin e korigjimit të informacioneve të rremë nga “Top Channel”, në lidhje me dy lajme të publikuara”*.

2.Administrimi i Ankesës

Pas shqyrtimit të materialit dhe përfundimit të procedurave administrative, Këshilli i Ankesave konstatoi se kronikat informative të transmetuara në “Top Channel” më 6 dhe 8 shkurt 2026 kishin përcjellë denoncimet e prindërve, reagimet institucionale dhe zhvillimet e mëtejshme të ngjarjes.

Nga materiali audioviziv rezultoi se media kishte informuar publikun për një çështje me interes publik, duke respektuar prezumimin e pafajësisë dhe parimin e interesit më të lartë të fëmijës. Për rrjedhojë, u vlerësua se raportimi ishte në përputhje me nenin 4, pika 2, të ligjit nr. 97/2013, si dhe pikën 1.4 të Kodit të Transmetimit.

Gjithashtu, pas kërkesës së paraqitur, “Top Channel” kishte korrigjuar të dhënat dhe informacionin e transmetuar. Për rrjedhojë, Këshilli i Ankesave konstatoi se media kishte përmbushur detyrimin e saj për informimin e publikut dhe kishte vepruar në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

3.Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Për rrjedhojë, Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive, konstatoi se në përmbushje të nenit 53, pikishte 13/f, nuk gjeti vend ushtrimi i të drejtës së përgjigjes nga D. V.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
S. L. B	MCN TV Fox News Albania		12.03.2026

1.Objekti i Ankesës

Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) i mbërriti për shqyrtim ankesë nga S.L.B me objekt “*mosvënie në dispozicion të shkresave zyrtare nga MCN Albania dhe Fox News Albania*”, si dhe pretendime të ngritura lidhur me materiale audiovizive të publikuara nga gazetari A.Ç.

2.Administrimi i Ankesës

Pas shqyrtimit të përmbajtjes së ankesës, ankuesit ju bë me dije ndër të tjera se:

- *Së pari*, në përmbajtjen e ankesës, nuk jepet asnjë referencë konkrete kohore lidhur me datën dhe orën e transmetimit të materialeve audiovizive objekt ankese, element thelbësor për identifikimin dhe verifikimin e përmbajtjes konkrete të transmetuar.
- *Së dyti*, në përputhje me nenin 37 të ligjit nr. 97/2013 “*Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizive kishtenë detyrimin ligjor që regjistrimet e transmetimeve t’i ruajnë për një periudhë jo më pak se tre muaj nga data e transmetimit.

3.Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në këtë kuadër, Autoriteti i Mediave Audiovizive, në ushtrim të kompetencave të tij, mund të mbështesë çdo kërkesë për vënie në dispozicion të materialeve audiovizive, brenda këtij afati ruajtjeje, për të cilat jepen të dhëna të sakta identifikuese (emisioni, data dhe ora e transmetimit).

Në mungesë të referencave konkrete kohore si edhe duke pasur parasysh kufirin ligjor të ruajtjes së regjistrimeve, Autoriteti nuk mund të kërkojë vënien në dispozicion të materialeve, të transmetuara jashtë afatit tre-mujor të parashikuar nga ligji.

Sakaq, për pjesën tjetër të ankesës që lidhet me pretendime për shpifje, përgjegjësi civile, marrëdhënie kontraktuale, forma jo korrekte financimi, dyshime për vepra penale, apo kërkesa për vënie në dispozicion të dokumentacionit zyrtar nuk hyn në kompetencat rregullatore të AMA-s, të cilat shtrihen mbi përmbajtjen audiovizive të transmetuar dhe respektimin e standardeve etiko-ligjore në transmetim.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
N.Sh.T.S.V	Blu tv Vlorë		30.03.2026

1. Objekti i Ankesës

Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) i mbërriti për shqyrtim ankesë nga N.SH.T.S.V me objekt: *“Një kronikë e publikuar në edicionin e lajmeve të televizionit lokishtel Blu TV Vlorë më datë 30 mars 2026”*. Ankuesi pretendonte se përmbajtja e lajmit ishte e pavërtetë, e pabazuar dhe cenonte reputacionin, ndaj kërkoi verifikimin e rastit, ndërprerjen e transmetimit dhe publikimin e një përgënjeshtrimi.

2.Administrimi i Ankesës

Në kuadër të administrimit të ankesës, Këshilli i Ankesave i kërkoi paraqitje pretendimesh nga subjekti audioviziv Blu TV, i cili sqaroi se kronikishte në fjalë ishte bazuar në raportin përkishtetës të Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSH), të muajit shkurt 2026, të cilin e vuri në dispozicion edhe të Këshillit të Ankesave. Pas verifikimit të kryer nga Këshilli i Ankesave, rezultoi, se kronika kishte përdorur si burim informacioni raportin e sipërpërmendur, të cilit i referohet gjatë gjithë kohës në gjetje dhe terminologji.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Për rrjedhojë, Këshilli i Ankesave nuk konstatoi shkelje të ligjit Nr.97/2013 *“Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, dhe të Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin nr. 60, datë 10.07.2023 (i amenduar me vendimin nr. 107, datë 11.11.2024).

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
D.L	Vizion Plus	Ferma vip	31.03.2026

1.Objekti i Ankesës

Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) i mbërriti për shqyrtim ankesë nga shtetasi D.L me objekt emisionin *“Ferma VIP”*, transmetuar më datë 30.03.2026 në

televizionin “Vizion Plus”. Në ankesë pretendohet se gjatë këtij transmetimi ishte përdorur gjuhë diskriminuese dhe denigruese nga moderatorja e programit, znj. Arbana Osmani, konkretisht shprehja “si pushkë e jevgut”.

2. Administrimi i Ankesës

Nga shqyrtimi i përmbajtjes audiovizive, u konstatua se më datë 30.03.2026, rreth orës 21:27, gjatë një bashkëbisedimi në program, ishte përdorur shprehja e sipërpërmendur, e cila – pavarësisht përdorimit të saj në gjuhën e folur – përmbante konotacion diskriminues dhe mund të shkakoje cenim të dinjitetit të individëve apo grupeve të caktuara. Në këto kushte, Këshilli i Ankesave kishte vlerësuar se përmbajtja audiovizive paraqet shmangie nga kuadri ligjor dhe nënligjor në fuqi, veçanërisht në drejtim të respektimit të dinjitetit dhe promovimit të mosdiskriminimit.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Për sa më sipër, Këshilli i Ankesave, në përfundim të shqyrtimit të kësaj çështjeje, vendosi t’i tërheqë vëmendjen subjektit audioviziv “Vizion Plus” për shmangie nga dispozitat e ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe të Kodit të Transmetimit si dhe t’i kërkojë subjektit që të ndërmarrë masa për editimin/ heqjen e sekuencës së sipërpërmendur nga materiali audioviziv.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
Klubi i Futbollit Vllaznia	RTSH	Super Gol	14.04.2026

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) kishte marrë një ankesë nga z.A.Xh, president i Klubit të Futbollit të Vllaznisë, me objekt emisionin “Supergol”, transmetuar në RTSH Sport, më datë 4 Prill 2026, ora 19:30, me titull “Post ndeshje /Egnatia - Bylis/ Partizani – Vllaznia. Në ankesë pretendohet se gjatë emisionit, moderatorja kishte përdorur gjuhë fyese ndaj tij.

2. Administrimi i Ankesës

Në kuadër të administrimit të ankesës së Klubit të Futbollit të Vllaznisë, Këshilli i Ankesave shqyrtoi përmbajtjen audiovizive, konkretisht emisionin “Supergol”, transmetuar në RTSH Sport, më datë 4 Prill 2026, ora 19:30, me titull “Post ndeshje /Egnatia - Bylis/ Partizani - Vllaznia ”.

Nga shqyrtimi përmbajtjes audiovizive u konstatuan deklaratat e pretenduara. Deklarata të tilla, bien ndesh me ligjin nr.97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, sipas të cilit: “veprimtaria e transmetimeve audiovizive respekton personalitetin, dinjitetin dhe të drejtat e liritë e tjera themelore të njeriut.”. (Neni 4, “Parimet themelore për veprimtarinë e transmetimeve audiovizive”, pikishte 1/b), si edhe - Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr.60, datë 10.07.2023, sipas të cilit: “Veprimtaria e transmetimeve audio dhe audiovizive ishte e lirë, respekton paanshmërisht të drejtën për informacion, bindjet politike e

besimet fetare, personalitetin, dinjitetin, normat morale dhe etike të shoqërisë si dhe kërkesat e deontologjisë së profesionit.”. (Seksioni 1, “Parimet themelore”, pikishte 1.3).

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Për sa më sipër, Këshilli i Ankesave i solli në vëmendje respektimin e dispozitave të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe nga Kodi i Transmetimit, miratuar me vendimin nr. 60, datë 10.07.2023, i ndryshuar.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
B.S	Report TV	Live me Odetën	15.04.2026

1. Objekti i Ankesës

Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) i mbërriti për shqyrtim ankesë nga shtetas B.S me objekt: “Disa video të publikuara në emisionin ‘Pa Gjurmë’ në Report TV dhe në kanalin zyrtar në YouTube të gazetares Odeta Dume”. Në ankesë, ndër të tjera, pretendohet se përmes transmetimit të këtyre materialeve ishte cenuar imazhi i ankueses, ishin paraqitur akuza të pabazuara dhe të njëanshme.

2. Administrimi i Ankesës

Në kuadër të administrimit të ankesës, Këshilli i Ankesave verifikoi përmbajtjen e materialeve audiovizive të vëna në dispozicion. Nga ky verifikimi rezultoi se trajtimi i çështjes në emisionin “Pa Gjurmë” në Report TV ishte shoqëruar me përmbajtje të publikuara në kanalin YouTube të gazetares Odeta Dume, të cilat, në thelb, shërbejnë si plotësim dhe balancim i informacionit të transmetuar, duke sjellë elemente dhe qëndrime shtesë mbi të njëjtin konflikt. Në lidhje me pretendimin për realizimin dhe publikimin e intervistës pa pëlqim, nga verifikimi i materialit nuk rezultoi asnjë indikator që të sugjerojë se intervistimi ishte kryer në mungesë vullneti apo se publikimi ishte bërë kundër dëshirës së personit të përfshirë. Përkundrazi, mënyra e zhvillimit të komunikimit dhe përmbajtja e materialit nuk evidentonin elementë të imponimit apo të ndërhyrjes së padrejtë.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në këto kushte, Këshilli i Ankesave nuk konstatoi elemente që të provojnë shkelje të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe të Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s nr. 60, datë 10.07.2023 (i amenduar me vendimin nr. 107, datë 11.11.2024).

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
M.Z	Syri TV	Piranjat	05.05.2026

1.Objekti i Ankesës

Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) i mbërriti për shqyrtim ankesë nga shtetasi M.Z, me objekt: “*një material audioviziv të publikuar në emisionin “Piranja” në televizionin Syri TV më datë 9 maj 2026*”. Në ankesë ky pretendohet se babai i ankuesit, Z.Z., ishte denoncuar nga emisioni “Piranjat” më 9 maj dhe, si pasojë, familja e tij ishte përballur me komente fyese dhe denigruese në Facebook dhe WhatsApp. Ankuesi kërkonte fshirjen e komenteve dhe marrjen e masave përkatëse, duke kërkuar që institucioni përgjegjës të mbante përgjegjësi për çdo pasojë të mundshme emocionale.

2.Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në kuadër të administrimit të ankesës, Këshilli i Ankesave – përputhur me kompetencat e veta - verifikoi fillimisht përmbajtjen e materialit audioviziv të transmetuar në emisionin “Piranja” në televizionin “Syri TV” më datë 9 maj 2026. Nga ky verifikim nuk u konstatuan shkelje të ligjit Nr. 97/2013 “*Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, dhe të Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s nr. 60, datë 10.07.2023 (). Këshilli i Ankesave konstatoi se programi e trajtoi çështjen duke u dhënë mundësi palëve të përfshira për të paraqitur qëndrimet e tyre.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
Ankues	Euro News Albania		18.05.2026

1.Objekti i Ankesës

Disa ankues nisën një ankesë Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive me pretendimin se dy panelistët R.A dhe M.L në televizionin “EuroNews Albania” kishin përdorur shprehje fyese kundrejt djemve pjesëmarrës në performancën e këngëtarit A.K në Eurovizion 2026.

2.Administrimi i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë (AMA) verifikoi përmbajtjen televizive transmetuar më datë 17 maj 2026 në televizionin Euronews Albania. Pas administrimit të përmbajtjes audiovizive, Këshilli i Ankesave vlerësoi se deklaratat e z. R.A dhe znj. M.L hyjnë në fushën e opinionëve dhe si të tilla hyjnë në kuadrin e lirisë së shprehjes.

3.Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Duke vlerësuar gjithë ndjeshmërinë dhe shqetësimin e ankuesve, Këshilli i Ankesave informoi se deklaratat e dy të ftuarve nuk përbëjnë shkelje ligjore apo të Kodit të Transmetimit.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
A.N			19.05.2026

1. Objekti i Ankesës

A.N nisi një ankesë me kërkesë vënien në dispozicion të praktikës së plotë administrative dhe sqarimin e kronologjisë procedurale dhe verifikimin e zbatimit efektiv të masave të marra lidhur me materialet audiovizive objekt ankesë.

2. Administrimi i Ankesës

Këshilli i Ankesave kishte shqyrtuar ankesat nëpërmjet të cilave pretendohet cenimi i privatësisë, dinjitetit dhe përpunimi i paligjshëm i të dhënave personale dhe sensitive në përmbajtjet audiovizive të transmetuara në “Syri TV” dhe të publikuara në llogaritë e tij online.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ, subjektit audioviziv “Syri TV” i ishte komunikuar masa paralajmëruese “Tërheqje vëmendjeje” nëpërmjet postës elektronike më datë 31.03.2026, së bashku me rekomandimin për editimin e përmbajtjeve audiovizive objekt ankesë.

Lidhur me këtë, ankuesja ishte informuar nga Këshilli i Ankesave përmes postës elektronike, si edhe me postës zyrtare.

Për kronologjinë e procedurave të ndjekura dhe hapat e ndërmarrë, ankuesja është vënë në dijeni nëpërmjet komunikimeve të sipërpërmendura, përfshirë rekomandimin e Këshillit të Ankesave për editimin e materialeve audiovizive në përputhje me standardet e parashikuara nga ligji nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Kodi i Transmetimit.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave nxiti subjektin të reagojë dhe aktualisht ndodhet në pritje të përgjigjes së tij lidhur me komunikimin e fundit por e ka të pamundur t’i imponohet medias në lidhje me materiale të publikuara në platforma të shpërndarjes së videove që ndodhen jashtë juridiksionit të Republikës së Shqipërisë apo të aplikojë sanksione ndaj saj për mos heqjen e tyre.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
R.H	TV Klan		25.05.2026
	Ora News		
	Balkanweb		
	Politiko		

1.Objekti i Ankesës

R.H i drejtoi njw ankesw Kwshillit tw Ankesave pranw Autoritetit tw Mediave Audiovizive me objekt: “Një lajm të publikuar më 23 qershor 2017”, në të cilën pretendonte se vijimësia e

aksesueshmërisë së këtij publikimi cenon të drejtat dhe jetën e saj private, pavarësisht se, sipas dokumentacionit të paraqitur, rezultonte e padënuar, si edhe kërkonte heqjen e tij nga faqet e internetit ku vijon të jetë i publikuar.

2.Administrimi i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive administroi ankesën e shtetases R.H dhe shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur në mbështetje të pretendimeve të ngritura. Në kuadër të këtij shqyrtimi, Këshilli iu drejtua shoqërive “TV Klan” sh.a. dhe “Ora News” sh.a. me rekomandim për të marrë në konsideratë kërkesën e saj, duke vlerësuar zhvillimet juridike të mëvonshme të dokumentuara dhe ndikimin që vijimësia e aksesueshmërisë së publikimit mund të ketë mbi të drejtat tuaja.

Ky rekomandim ishte mbështetur në nenin 4, pikishte 1, shkronjat "b" dhe "ç", si edhe pikishte 2, shkronja "ç", të Ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe në nenin 16 të Ligjit nr. 124/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", në lidhje me nenin 15 dhe nenin 6, pikishtet 4 dhe 5 të po këtij ligji.

3.Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Sa u përket publikimeve të tjera të referuara në ankesën e shtetases R.H, të kryera nga portale informative ose media të tjera online, ankueses iu bë me dije se ato nuk përfshihen në juridiksionin e Autoritetit të Mediave Audiovizive dhe, për pasojë, AMA nuk disponon kompetencë ligjore për të ndërhyrë mbi përmbajtjen e tyre.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
Dhjetëra ankues	Abc News	Real Story	02.06.2026

1.Objekti i Ankesës

Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) i mbërritën për shqyrtim dhjetëra ankesa lidhur me emisionin “Real Story”, me temë “Zverneci, pikëtakimi i ‘rastësive’”, transmetuar në televizionin ABC News më datë 01.06.2026, ora 20:05.

2.Administrimi i Ankesës

Në kuadër të administrimit të ankesës se dhjetra ankuesve Këshilli shqyrtoi përmbajtjen e ankesës, përmbajtjen audiovizive të emisionit, si edhe pretendimet e paraqitura nga shoqëria “ABC News” sh.a. Nga shqyrtimi i përmbajtjes audiovizive dhe pretendimeve të paraqitura nga subjekti rezultoi se gjatë emisionit u publikua një fotografi e paraqitur nga një prej të ftuarve në studio si fotografi e realizuar në pikën kufitare të Kishtekishtëvijës, e cila u përdor gjatë debatit për të mbështetur pretendime lidhur me organizimin e protestës së Zvernecit dhe u kthye objekt diskutimi nga panelistët e emisionit.

Në pretendimet e saj, shoqëria “ABC News” sh.a. sqaroi se fotografia nuk ishte material i prodhuar apo i përgatitur nga redaksia, por ishte paraqitur nga një i ftuar gjatë transmetimit të drejtpërdrejtë,

se moderatori nuk kishte dijeni paraprake për të dhe se, për shkak të natyrës live të emisionit, nuk kishte qenë e mundur kryerja e një verifikimi të menjëhershëm të autenticitetit të saj.

Megjithatë, Këshilli i Ankesave vlerësoi se, pavarësisht këtyre rrethanave, fotografia u përdor si referencë për komente dhe interpretime mbi një çështje me interes të lartë publik, ndërkohë që autenticiteti i saj nuk rezultonte i verifikuar, duke krijuar potencialisht tek publiku perceptimin se informacioni i paraqitur përbënte një fakt të konfirmuar.

3.Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Referuar ligjit Nr.97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, konkretisht nenit 4, pikishte 1, shkronja “ç”, sipas të cilit transmetimet audiovizive duhet të sigurojnë informim objektiv dhe të paanshëm të publikut, duke paraqitur në mënyrë të saktë faktet dhe ngjarjet dhe duke respektuar formimin e lirë të opinionit publik, Këshilli i Ankesave vendosi t’i sjellë në vëmendje shoqërisë “ABC News” sh.a. nevojën për të treguar kujdes të shtuar editorial në trajtimin e materialeve të paverifikuara gjatë transmetimeve live.

Gjithashtu, Këshilli i Ankesave i rekomandoi subjektit që, në raste të ngjashme, publiku të informohej qartë kur materiale të caktuara nuk ishin verifikuar nga redaksia si edhe që, në rastet e kontestimeve serioze mbi autenticitetin e materialeve të transmetuara, të vlerësohet marrja e masave korrigjuese në përmbajtjet e publikuara në platformat online të subjektit.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
E.Sh	News 24	Me zemër të hapur	03.06.2026

1.Objekti i Ankesës

Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) i mbërriti për shqyrtim ankesë nga shtetasja E.Sh me objekt transmetimin e emisionit “Me zemër të hapur”, të transmetuar në televizionin “News24” më datë 01.06.2026. Në ankesë shtetasja E.Sh pretendonte se gjatë transmetimit ishin cenuar të drejtat e saj dhe të familjarëve, përmes identifikimit të tërthortë, regjistrimit pa miratim të një bisede telefonike dhe transmetimit të materialeve audiovizive për të cilat ekzistonte një vendim i mëparshëm për heqjen e tyre nga platforma YouTube.

2.Administrimi i Ankesës

Pas administrimit të dokumentacionit të paraqitur nga palët dhe monitorimit të materialit audioviziv objekt ankese, Këshilli i Ankesave arriti në përfundimin se pretendimi i shtetasës E.Sh lidhur me mënyrën e realizimit të regjistrimit telefonik ankueses iu sqaru nuk bën pjesë në kompetencën e Autoritetit të Mediave Audiovizive. Ligjshmëria e sigurimit të materialeve audiovizive dhe përgjegjësia që mund të lindë nga realizimi i tyre ishin çështje që i përkasin juridiksionit të organeve të tjera kompetente. Për këtë arsye, Këshilli nuk ishte shprehur mbi këtë pretendim.

Nga ana tjetër, shqyrtimi i përmbajtjes së emisionit rezultoi se, megjithëse identiteti i shtetasës E.Sh nuk u bë publik në mënyrë të drejtpërdrejtë, kombinimi i elementëve të transmetuar gjatë

emisionit dhe në publikimet shoqëruese mundësonte identifikimin tuaj dhe të familjarëve nga publiku. Këshilli vlerësoi se, në rrethanat konkrete të rastit, interesi publik nuk impononte një identifikim të tillë dhe se materiali mund të transmetohej duke përdorur masa më efektive anonimizimi, pa cenuar vlerën informative të emisionit. Për rrjedhojë, u konstatua se subjekti audioviziv nuk kishte marrë të gjitha masat editoriale të nevojshme për mbrojtjen e jetës private dhe të të dhënave personale, në kundërshtim me nenin 46 të ligjit nr. 97/2013 dhe standardet përkishtetëse të Kodit të Transmetimit.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Për këto arsye, Këshilli i Ankesave i kishte tërhequr vëmendjen subjektit audioviziv TV News24 për shmangien e konstatuar dhe i kishte kërkuar: të mos ritransmetojë materialet objekt shqyrtimi në formën aktuale; të redaktojë materialet e publikuara në kishtenalet e tij zyrtare, përfshirë YouTube, Instagram dhe faqen e internetit, duke eliminuar elementët që mundësojnë identifikimin tuaj dhe të familjarëve tuaj; të marrë masa editoriale që në raste të ngjashme të garantojë anonimizimin efektiv të personave privatë, kur identifikimi i tyre nuk justifikohet nga një interes publik mbizotërues.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
P.N			08.06.2026

1.Objekti i Ankesës

Shtetasi P.N i drejtoi Këshillit të Ankesave një ankesë me objekt kërkesën për ndihmë për fshirjen e publikimeve audiovizive dhe lajmeve të shkruara, për të cilat pretendonte se mbajtja online e publikimeve të lidhura me një ngjarje të datës 07.06.2016 cenonte të drejtat dhe jetën private të tij. Gjithashtu ankuesi bashkëlidhur ankesës kishte nisur edhe dokumentacion ku vërtetohej pushimi i procedimit penal.

2.Administrimi i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive pasi administroi ankesën e shtetasit P.N dhe shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur në mbështetje të pretendimeve të ngritura, ju drejtua “TV Klan” dhe “Ora News” me rekomandimin për të marrë në konsideratë kërkesën e tij lidhur me heqjen e materialit të publikuar, në vlerësim të zhvillimeve juridike të evidentuara në dokumentacionin e administruar.

Në mbështetje të nenit 4, pikishte 1, shkronja “ç” të ligjit nr. 97/2013 “*Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, sipas të cilit transmetimet audiovizive duhet të sigurojnë informim objektiv dhe të paanshëm të publikut, duke paraqitur në mënyrë të saktë faktet dhe ngjarjet dhe duke respektuar formimin e lirë të opinionit publik, Këshilli i Ankesave vendosi t’i sjellë në vëmendje shoqërisë “ABC News” sh.a. nevojën për të treguar kujdes të shtuar editorial në trajtimin e materialeve të paverifikuara gjatë transmetimeve live.

Gjithashtu, Këshilli i Ankesave i rekomandoi subjektit që, në raste të ngjashme, publiku të informohet qartë kur materiale të caktuara nuk ishin verifikuar nga redaksia si edhe që, në rastet e kontestimeve serioze mbi autenticitetin e materialeve të transmetuara, të vlerësohet marrja e masave korrigjuese në përmbajtjet e publikuara në platformat online të subjektit.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Sa u përket publikimeve të tjera, të referuara në ankesë, lidhje me portale informative, ankuesit iu bë me dije se ato ishin jashtë juridiksionit të Autoritetit të Mediave Audiovizive dhe, për pasojë, dhe jashtë kompetencave të tij.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
D.M	Top-Channel	Top Story	15.06.2026

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) kishte marrë një ankesë më datë 15.06.2026 me nr prot 1569 nga shtetasja D.M.Hoxha, me objekt: *“Shkelje e rëndë e parimeve etike-profesionale, përdorimit të gjuhës denigruese, seksiste dhe dehumanizuese, si dhe fyerje publike në emisionin “Top Story” në Top Channel më datë 10.06.2026”*.

2.Administrimi i Ankesës

Këshilli i Ankesave administroi ankesën e shtetases D.M.H dhe verifikoi përmbajtjen audiovizive të transmetuar më datë 10 qershor 2026 në emisionin “Top Story” në Top Channel në orën 22:00.

Pas verifikimit të materialit audioviziv Këshilli i Ankesave doli në konkluzionin se shprehjet e thëna në program, konkretisht në orën 22:36 minuta nga shtetasi B.M nuk përbënin shkelje të ligjit nr.97/2013 *“Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”*, dhe Kodit të Transmetimit. Jo se ato nuk cënonin figurën ankueses, por se ndërhyrja e drejtueses së emisionit znj G.D ishte e duhura dhe shteruese.

Këshilli i Ankesave gjithashtu verifikoi dhe përmbajtjet e shpërndara në platformat e televizionit Top Channel ku konstatoi se lajmet për këtë emision ishin shoqëruar me tituj jo të përshtatshëm dhe aspak në linjën që mbajti drejtuesja e programit gjatë emisionit live.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Për këtë arsye Këshilli i Ankesave i rekomandoi televizionit “Top Channel” të heqë nga platformat e saj çdo material që cënon figurën e ankueses shtetases D.M.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
M.Z	TV Klan	Stop	19.06.2026

1.Objekti i Ankesës

Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive i mbërriti për shqyrtim një ankesë nga shtetasja M.Z. Ankuesja pretendonte se në emisionin “Stop”, në televizionin “TV Klan”, më datë 08.06.2026: *“ishte publikuar varianti përrudimtar pa miratimin dhe dijeninë e saj, pavarësisht kërkesës për t’u informuar dhe se ky transmetim i kishte cenuar imazhin dhe dinjitetin, me pasoja për jetën private”*.

2.Administrimi i Ankesës

Në kuadrin e administrimit të ankesës, Këshilli i Ankesave i kërkoi OSHMA-së, “TV Klan” paraqitje e pretendimesh, në mbështetje të nenit 51 të ligjit nr. 97/2013 *“Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, rregullores *“Mbi procedurat për shqyrtimin e ankesave nga Këshilli i Ankesave dhe të drejtës së përgjigjes”*, si dhe udhëzimit *“Mbi procedurat e trajtimit të ankesave nga Ofruesit e Shërbimit Mediatik Audioviziv”*. Në përgjigje të kërkesës së Këshillit të Ankesave për paraqitjen e pretendimeve, OSHMA-ja sqaroi se: *“ankueses i ishte dhënë mundësia të shprehë qëndrimin e saj nëpërmjet një interviste, e cila ishte zhvilluar me dijeninë dhe pëlqimin e saj (vetë ankuesja kishte konfirmuar se bëhet fjalë për një intervistë), pretendimi për komunikim me përmbajtje kërcënuese nga ana e redaksisë, nuk rezulton të jetë i bazuar”*.

3.Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Referuar pretendimeve të OSHMA-së dhe shqyrtimit të përmbajtjes audiovizive transmetuar në emisionin “Stop”, në “TV Klan”, Këshilli i Ankesave vlerësoi se transmetimi i përmbajtjes audiovizive, nisur edhe nga natyra e emisionit, investigativo-satirik “Stop”, kishte në thelb trajtimin e ngjarjeve të aktualitet në shërbim të interesit publik. Për rrjedhojë, u vlerësua se çështja e trajtuar në emision, përbën interes publik. Në lidhje me pretendime të tjera, ankueses iu sqaru se AMA, në cilësinë e autoritetit rregullator në fushën e shërbimeve audiovizive, vepra penale e “kërcënimit” ishte jashtë kompetencave të tij.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
Gj.K	MCN TV	Xhadat	22.06.2026

1.Objekti i Ankesës

Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) i mbërriti një ankesë nga z. Gj.K lidhur me një seri emisionesh investiguese të transmetuara nga subjekti audioviziv MCN TV, kryesisht në emisionin “Xhadat”, si dhe publikimet e lidhura me to në platformat online të subjektit. Ankesa kishte për objekt pretendimin për shkelje të parimeve të veprimtarisë mediatike, cenim të dinjitetit, reputacionit profesional dhe jetës private të ankuesit, shkelje të prezumimit të pafajësisë, mungesë të balancimit të informacionit, si dhe përdorimin e titujve dhe formulimeve editoriale që, sipas ankuesit, krijojnë një perceptim paragjyqës dhe denigruan ndaj figurës së tij. Ankuesi pretendoi gjithashtu se publikimet nuk pasqyrojnë zhvillimet juridike të mëvonshme, përfshirë vendimet gjyqësore dhe dokumentacionin që, sipas tij, rrëzonin një pjesë të pretendimeve të ngritura në investigim.

2.Administrimi i Ankesës

Në kuadër të administrimit të kësaj çështjeje, Këshilli i Ankesave ndoqi procedurën si më poshtë:

- Më 15.01.2026, AMA administroi ankesën e parë të z. Gj.K lidhur me xhirimet pranë zyrës së tij noteriale, cenimin e privatësisë dhe pengimin e veprimtarisë profesionale.
- Më 29.01.2026, ankuesi paraqiti një shkresë shtesë, duke pretenduar vijimin e veprimeve të ekipit televiziv.
- Më 09.02.2026, Këshilli e informoi se mënyra e realizimit të xhirimeve në terren nuk ishte në juridiksionin e AMA-s.
- Më 22.06.2026, ankuesi paraqiti një ankesë të re, tashmë lidhur me përmbajtjen e transmetimeve dhe publikimeve të MCN TV.
- Më 29.06.2026, Këshilli kërkoi individualizimin e materialeve të kundërshtuara dhe rikujtoi afatin ligjor.
- Ankuesi paraqiti 25 materiale audiovizive dhe online për periudhën nëntor 2025–qershor 2026, si dhe dokumentacion shtesë.

Këshilli kërkoi qëndrimin e Bordit të Shqyrtimit të Ankesave pranë MCN TV. OSHMA-ja paraqiti pretendimet e tij. Në vijim, KA kërkoi zhvillimin e seancës dëgjimore me të dy palët ankuese.

3.Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit dhe dëgjimit të palëve Këshilli ndër të tjera konstatoi se investigimi gazetaresk për çështje me interes publik përbën ushtrim të ligjshëm të lirisë editoriale. Gjithashtu, se një pjesë e titujve të publikimeve promovuese në platformat online, nuk pasqyrojnë përmbajtjen e materialeve audiovizive dhe nuk përmbushin standardin etik dhe profesional të përgjegjësisë editoriale.

Për rrjedhojë, i rekomandoi subjektit audioviziv MCN TV: të njohë dhe të ushtrojë të drejtën e përgjigjes së ankuesit, në përputhje me nenin 53 të ligjit nr. 97/2013; të rishikojë formulimin e titujve promovues të materialeve objekt ankese në platformat e veta online, në mënyrë që ato të jenë në përputhje me standardet profesionale të raportimit. I tërhoqi vëmendjen subjektit audioviziv MCN TV që, në raportimet e ardhshme mbi çështje me interes publik, të garantojë proporcionalitet mes rasteve të ngjashme të investiguara si në intensitet, ashtu edhe në thellësi dhe kohëzgjatje, të garantojë balancë të vazhdueshme të informacionit, duke marrë në konsideratë edhe zhvillimet juridike ose institucionale, kur ato ndikojnë në perceptimin e publikut.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
L.E	Report TV	Pa gjurmë	24.06.2026

1.Objekti i Ankesës

Shtetasja L.E i nisi një ankesë Këshillit të Ankesave me objekt OSHMA-në “Report TV”. Ankuesja pretendonte se media nuk kishte zbatuar të drejtën e përgjigjes, të njohur më parë nga Këshilli i Ankesave.

2.Administrimi i Ankesës

Nga përgjigjja e administruar rezulton se moderatorja e emisionit kishte rikonfirmuar gatishmërinë për t'ju mundësuar ushtrimin e së drejtës së përgjigjes, duke deklaruar se ju përveç ftesës publike, kishte ndërmarrë përpjekje për kontakte të mëtejshme me familjen tuaj, duke konfirmuar njëkohësisht, se emisioni "Pa Gjurmë" mbetet i hapur për të garantuar pjesëmarrjen tuaj në të.

Në këto kushte, Këshilli i Ankesave çmon se e drejta e përgjigjes, e njohur prej tij dhe e pranuar për zbatim nga ofruesi i shërbimit mediatik audioviziv "Report TV", vijon të jetë e garantuar. Realizimi i saj konkret kërkon bashkëpunimin dhe vullnetin e të dyja palëve.

3.Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Ankueses ju bë me dije se Autoriteti i Mediave Audiovizive nuk organizon, ndërmjetëson apo shoqëron procesin e realizimit të së drejtës së përgjigjes. Roli i tij konsiston në shqyrtimin e ankesës, njohjen e së drejtës së përgjigjes kur konstatohen kushtet ligjore dhe njoftimin e subjektit mediatik lidhur me detyrimin për garantimin e ushtrimit të saj. Për rrjedhojë, komunikimi për mënyrën dhe momentin e ushtrimit të kësaj të drejte mbetet në përgjegjësinë e drejtpërdrejtë të palëve.

Nisur nga fakti që subjekti mediatik kishte shprehur gatishmërinë për të mundësuar ushtrimin e së drejtës së përgjigjes dhe nuk refuzonte realizimin e saj, Këshilli nuk konstatoi rrethana që të justifikonte ndërhyrje të mëtejshme nga ana e Autoritetit.

ANKESA ME OBJEKT "CENIMIN E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE"

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
ALO116	Top Channel	Shqipëria Live	06.01.2026

1. Objekti i Ankesës

Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive i mbërriti një ankesë nga "ALO116", me objekt emisionin "Shqipëria Live", transmetuar në televizionin "Top Channel" më 5 Janar 2026. Në ankesë pretendohet se intervistimi i gjyshit të vajzës 12 vjeçare të abuzuar seksualisht në Pogradec, tejkishte etikën gazetareske dhe mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijës.

2. Administrimi i Ankesës

Emisionin "Shqipëria Live", i transmetuar në televizionin "Top Channel", më datë 05.01.2026, me titull: Rrëqethëse/ Rrëfimi i gjyshit të 12-vjeçares: Mbesën ma abuzoi komshiu 70 vjeç". Nga shqyrtimi i materialit filmik rezultoi se i intervistuari, gjyshi i fëmijës së abuzuar seksualisht, kishte pranuar vullnetarisht të jepte intervistë për median, duke vendosur si kusht të vetëm

mosidentifikimin e tij me emër dhe mbiemër. Ky kusht ishte respektuar nga transmetuesi audioviziv, duke ruajtur anonimitetin e tij. Në intervistë, i moshuari deklaronte se familja nuk kishte gjetur mbështetje institucionale nga strukturat përkishtetëse shtetërore dhe se media kishte qenë i vetmi kishtenal që i kishte dhënë zë situatës së tyre. Ai apelonte për ndihmë, për ndërhyrje dhe zbatim të ligjit nga institucionet kompetente, duke kërkuar që çështja të trajtohet brenda kornizës ligjore.

Nga përmbajtja e intervistës evidentohet se situata familjare ishte tejte e rëndë, pasi familja e vajzës së abuzuar, duke u ndjerë e braktisur nga shteti dhe instancat përgjegjëse, ishte detyruar të largohej nga zona ku banonte, duke braktisur edhe banesën e tyre. Gjithashtu, në intervistë ngrihej shqetësimi se sjellja e personit të dyshuar, 70-vjeçarit, mund të përbente rrezik edhe për fëmijë të tjerë të zonës.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli konstatoi se gjatë zhvillimit të intervistës nuk ishin dhënë të dhëna identifikuese drejtpërdrejtë për fëmijën viktimë dhe nuk ishin zbuluar elemente që cenonin drejtpërdrejt identitetin apo privatësinë e saj. Disa hollësi rrethanore që dëlnin gjatë bisedës duket se ishin pasojë e rrëfimit spontan të të intervistuarit dhe menaxhimit të situatës nga gazetarja në terren, e cila kishte ruajtur një qasje të përmbajtur dhe informuese.

Këshilli i Ankesave vlerësoi gjithashtu se pjesët e transmetuara nga intervista nuk ishin përdorur në asnjë moment për qëllime sensacionale. Përmbajtja e transmetuar përbente nga deklaramë faktike të dhëna nga i moshuari, në formën e një rrëfimi personal mbi situatën familjare dhe rrethanat e ngjarjes, pa ndërhyrje apo theksime që synojnë dramatizimin apo amplifikimin emocional të ngjarjes.

Nga shqyrtimi i materialit rezultoi se media nuk kishte spekuluar me elemente të ngjarjes, nuk kishte shtuar problematikisht apo interpretime të pabazuara dhe nuk kishte përdorur gjuhë nxitëse apo denigruese.

Përkundrazi, çështja e trajtuar ishte evidentuar dhe adresuar edhe nga paneli i të ftuarve në studio, të cilët kishin trajtuar rastin në një këndvështrim informues dhe institucional, duke theksuar nevojën për reagim të organeve kompetente dhe mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijës.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
A.W.A	MCN /Top Channel	Kronikë	14.01.2026

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) shqyrtoi ankesën e A.W.A lidhur me mënyrën e raportimit mediatik të rastit të abuzimit të një të miture 12-vjeçare në qytetin e Pogradecit, për të cilin shprehni shqetësimin mbi cenimin e mbrojtjes së identitetit të fëmijës viktimë dhe shkeljen e parimeve të Kodit të Transmetimit.

2. Administrimi i Ankesës

Në vijim të ankesës së një familjari të vajzës, shqetësimit si edhe në kuadrin e monitorimeve të veta, Autoriteti ndëri mbërriti verifikimin e mënyrës së raportimit në mediat audiovizive për ngjarjen në fjalë.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Nga vlerësimi i përmbajtjeve audiovizive rezultoi se, në përgjithësi, mediat audiovizive ishin përpjekur të shmangin identifikimin e drejtpërdrejtë të të miturës viktimë, duke mos publikuar pamje apo të dhëna nominale. Megjithatë, në disa raste ishin konstatuar elementë rrethanorë që, të marra së bashku, kishin krijuar rrezik për identifikim indirekt të të miturës, si përmendja e zonës apo vendndodhjes së ngjarjes, publikimi i pamjeve të fshatit ose mjedisit përreth, intervistimi i të afërmeve apo fqinjëve, si dhe përdorimi i zërit pa maskim të mjaftueshëm.

Bazuar në sa më sipër dhe në natyrën e përmbajtjeve të shqyrtuara, Autoriteti, nga njëra anë, çmoi se rasti i referuar përbën një ngjarje me ndjeshmëri të lartë shoqërore, që përfshinte një fëmijë viktimë të një veprë penale të rëndë, për të cilën raportimi kërkonte respektim rigoroz të interesit më të lartë të fëmijës sipas Kodit të Transmetimit dhe legjislacionit në fuqi.

Megjithatë, duke qenë se problematizohet e konstatuara lidhen kryesisht me publikim e të dhënave rrethanore, si pasojë e fokusimit të mbrojtja e fëmijës, këto praktikishte nuk u vlerësuan si shkelje të qëllimshme që të justifikonin marrjen e masave administrative, por si arsye të mjaftueshme për ndërhyrje me kisharakter sensibilizues dhe orientues.

Për këtë arsye, Autoriteti ndërhyri në funksionin e tij rregullator, përmes nxjerrjes dhe publikimit të një Thirrjeje Sensibilizuese, drejtuar të gjitha mediave audiovizive, e cila ishte bërë publike në faqen zyrtare të AMA-s dhe u ishte përcjellë subjekteve audiovizive në formë elektronike. Kjo thirrje synon rikujtimin dhe forcimin e detyrimeve editoriale lidhur me mbrojtjen e fëmijëve viktimë, shmangien e çdo forme identifikimi të drejtpërdrejtë apo indirekte dhe përdorimin e një gjuhe të përgjegjshme, të balancuar dhe jo-sensacionaliste.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
L.Gj	Top-Channel	Fiks Fare	16.02.2026

1.Objekti i Ankesës

L.Gj i nisi një ankesë Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) me objekt *“fshirjen e plotë dhe të menjëhershme të materialit audioviziv ku përfshihet rasti i fëmijës, duke pretenduar cenim të privatësisë, dinjitetit dhe sigurisë së tij”*.

Kjo ankesë erdhi pas ankesës të pare pranë Autoritetit, mbërritur në formë elektronike më datë 09.12.2025, në vijim të të cilës Këshilli Ankesave verifikoi përmbajtjen audiovizive të transmetuar në emisionin “Fiks Fare”, datë 4 dhjetor 2025 dhe i tërhoqi vëmendjen Top Channel, duke kërkuar mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijës.

2.Administrimi i Ankesës

Në kuadër të administrimit të kësaj ankesë, Këshilli i Ankesave i mbërriti në shqyrtim dhe përgjigjen zyrtare të subjektit audioviziv “Top Channel”, dërguar Autoritetit të Mediave Audiovizive në vijim të tërheqjes së vëmendjes nga AMA, ku theksohet se:

- Së pari, kontaktimi i emisionit “Fiks Fare” ishte bërë me iniciativë të drejtpërdrejtë nga vetë nëna e fëmijës, e cila kishte kërkuar ndihmë pranë sekretarisë së emisionit, kishte dhënë intervistë me vullnetin e saj dhe kishte vënë në dispozicion materiale filmike të realizuara prej saj, me qëllim denoncimin e situatës së bullizimit.
- Së dyti, gjatë transmetimit të emisionit, identiteti i fëmijës ishte mbrojtur, duke u aplikuar teknikë e mbulimit të fytyrës (blur), pa përmendur emër, mbiemër apo elementë identifikues të drejtpërdrejtë të tij. Kjo ishte konfirmuar edhe nga vetë subjekti audioviziv në përgjigjen zyrtare drejtuar AMA-s
- Së treti, intervista e nënës ishte transmetuar me identifikim, me deklaram të shprehur vullnetar, në cilësinë e kujdestares ligjore të fëmijës, përgjegjësi që ajo e kishte marrë përsipër në momentin e komunikimit me median.
- Së kishetërti, subjekti audioviziv kishte bërë me dije se, në vijim të ndërhyrjes së AMA-s, do të aplikojë masa shtesë mbrojtëse për të dhënat personale të familjarëve, duke mbuluar edhe figurën e fytyrës së nënës në transmetimet pasuese, në funksion të interesit më të lartë të fëmijës.

3.Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në këto kushte, Këshilli i Ankesave vlerësoi se për sa i përket imazhit dhe identitetit të fëmijës, kërkesa për mbrojtje ishte ezauruar, pasi transmetimi kishte masa mbrojtëse të identitetit, në përputhje me parimet e Kodit të Transmetimit dhe standardet për mbrojtjen e të miturve.

Njëkohësisht, Këshilli i Ankesave theksoi se Autoriteti i Mediave Audiovizive nuk mund të urdhërojë fshirjen e plotë të materialeve nga të gjitha platformat, aq më tepër kur kjo ishte kërkuar dhe iniciuar, por ushtron funksion rregullator dhe mbikëqyrës mbi respektimin e standardeve ligjore dhe etike nga ofruesit e shërbimeve audiovizive.

Në përfundim, Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive, bazuar në verifikimet e kryera dhe dokumentacionin e administruar, konstatoi se media kishte plotësuar detyrimet e kërkuara prej Ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Kodit të Transmetimit, lidhur me mbrojtjen e identitetit të fëmijës në transmetimin e sipërcituar.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
J.M	Media		24.02.2026

1. Objekti i Ankesës

J.M nisi një ankesë Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) me objekt një reklamë të “Universal Eye Hospital” në Tiranë, të transmetuar në Syri TV dhe media të tjera. Në ankesë shtetasi J.M pretendonte se *“gjatë gjithë spotit publicitar shfaqen fëmijë, të cilët vetëm për shkishtek se mbajnë syze, vihen në lojë dhe përballen me tallje të vazhdueshme nga moshatarët e tyre”*. Për këtë arsye, kërkoi nga Autoriteti i Mediave Audiovizive marrjen e masave në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Administrimi i Ankesës

Në kuadër të administrimit të ankesës, Këshilli i Ankesave shqyrtoi përmbajtjen audiovizive me natyrë tregtare, konkretisht reklamën e “Universal Eye Hospital”, të transmetuar nga Syri TV dhe media të tjera. Nga këqyrja e materialit audioviziv, u evidentua se përmbajtja e saj nuk ishte në përputhje me kërkesat e Kodit të Transmetimit, i cili përcakton se komunikimet me natyrë tregtare duhet të jenë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe të udhëhiqen nga parimi i mbrojtjes së fëmijëve nga dëmet morale dhe fizike, duke shmangur çdo formë paraqitjeje që mund të cenojë dinjitetin apo mirëqenien e tyre.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Autoriteti i Mediave Audiovizive i’u drejtua subjektit përkishtetës prodhues të materialit, duke kërkuar rishqyrtimin e përmbajtjes në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 97/2013 *“Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, si dhe me aktet nënligjore përkishtetëse.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
A.SH.M.D.F	Top-Channel	Shqipëria live	01.04.2026

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) shqyrtoi ankesën e A.SH.M.D.F, të paraqitur përmes postës elektronike (info@ama.gov.al) më datë 30.03.2026, me objekt: emisionin “Shqipëria Live”, transmetuar në televizionin Top Channel në datë 20.03.2026, ku pretendohet se:

- “në emisionin “Shqipëria Live” ishte transmetuar një video, për të cilën, sipas ankuesit (babait të fëmijës), ishin cenuar të drejtat e fëmijës në transmetimet audiovizive;
- megjithëse nuk ishin publikuar drejtpërdrejt të dhëna personale apo imazhe të fëmijës, identifikimi i tij bëhet i mundshëm në mënyrë indirekte, përmes publikimit të videos së shpërndarë nga nëna dhe ritransmetuar në televizion;
- për sa më sipër, kërkoi marrjen e masave sipas legjislacionit në fuqi për emisionin “Shqipëria Live” në televizionin Top Channel”.

2. Administrimi i Ankesës

Këshilli i Ankesave shqyrtoi materialin audioviziv të transmetuar në emisionin “Shqipëria Live”, në televizionin Top Channel, në datën e sipërcituar, në funksion të verifikimit të përputhshmërisë

së tij me kërkesat e ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe me standardet e Kodit të Transmetimit.

Nga shqyrtimi i përmbajtjes audiovizive rezultoi se:

- *materiali i transmetuar lidhej me një video të publikuar më parë në rrjete sociale nga nëna e fëmijës;*
- *nëna e fëmijës publikonte të dhënat personale të psikologes, duke habur debat publik mbi profesionalizmin e saj;*
- *në program nuk publikohen të dhëna identifikuese të drejtpërdrejta të fëmijës;*
- *për shkak të statusit publik të prindit dhe kontekstit të trajtimit të çështjes, krijohet mundësia e identifikimit indirekt të fëmijës;*
- *emisioni, nisur nga reagimi i publikuar nga nëna e fëmijës në rrjete sociale, tentoi ta trajtojë çështjen nga këndvështrimi i interesit të fëmijës;*
- *diskutimi në studio dhe ndërhyrjet e specialistëve të ftuar, si edhe kontributet përmes lidhjeve të drejtpërdrejta jashtë studios, reflektojnë një qasje orientuese dhe sensibilizuese lidhur me mbrojtjen e të drejtave të fëmijës.*

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në vlerësim të këtyre rrethanave, Këshilli i Ankesave, bazuar në dispozitat e ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Kodit të Transmetimit, miratuar me Vendimin e AMA-s, Nr. 60, datë 10.07.2023,

- i risolli në vëmendje subjektit audioviziv TOP Channel nevojën e kujdesit të shtuar editorial në trajtimin e temave të tilla sensitive, duke u ndalur posaçërisht në detyrimin për:
- shmangien e çdo elementi që mund të çojë në identifikimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të të miturit, veçanërisht në raste që lidhen me konflikte familjare;
- shmangien e identifikimit indirekt të fëmijës, edhe përmes palëve të treta;
- shmangien e publikimit të paautorizuar të të dhënave personale;

me synim, respektimin e interesit më të lartë të fëmijës, si një standard që duhet të prevalojë mbi çdo interes tjetër editorial apo publik dhe garantimin e mbrojtjes së të drejtave themelore të çdo qytetari, në çdo rast, kur kjo nuk bie ndesh me interesin publik.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
A.B	Top-Channel	Fiks Fare	07.04.2026

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) shqyrtoi ankesën e shtetasit A.B të paraqitur përmes postës elektronike (info@ama.gov.al) më datë 04.04.2026, me objekt: “Një material të publikuar në emisionin Fiks Fare në televizionin Top Channel”.

Në ankesë shtetasi A.B ndër të tjera, parashtronte se në transmetimin e datës 27.03.2026 ishte përfshirë fëmija i tij i mitur pa pëlqimin e tij dhe kërkonte heqjen e materialit, duke bërë me dije gjithashtu se për këtë çështje i ishte drejtuar dhe Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

2. Administrimi i Ankesës

Megjithatë, ankesa kishte të bënte me një fëmije - Këshilli i Ankesave kreu një verifikim paraprak të materialit audioviziv të transmetuar, nga i cili rezultoi se gjatë emisionit Fiks Fare të datës 27 mars 2026 nuk ishin publikuar të dhëna personale që mund të çonin në identifikimin e të miturit nga publiku i gjerë, u përdorën masa mbrojtëse dhe teknikisht mbulimi të imazhit, në përputhje me kërkesat për mbrojtjen e të miturve. Në këto kushte, nuk u konstatuan elemente që të përbëjnë shkelje të ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe të Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin nr. 60, datë 10.07.2023 (i amenduar me vendimin nr. 107, datë 11.11.2024).

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Nisur nga informacioni i dhënë prej ankuesit, duke qenë, se çështja ishte bërë objekt shqyrtimi nga organet e drejtësisë, ju sqarojmë se, në përputhje me nenin 53, pikishte 13/gj të ligjit nr. 97/2013, Këshilli i Ankesave nuk vijon dot me trajtimin e një ankese, që po shqyrtohet në kuadër të një procesi gjyqësor.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
E.K	Top-Channel	Kronikë	10.04.2026

1. Objekti i Ankesës

Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) i mbërriti në shqyrtim ankesën e shtetasit E.K të paraqitur përmes postës elektronike (info@ama.gov.al) më datë 09.04.2026, me objekt një kronikë të publikuar në platformat e televizionit Top Channel.

Në kuadër të administrimit të ankesës pretendohet se lajmi i publikuar në datë 7 prill 2026 në platformat e Top Channel ishte i rremë. Sipas ankuesit, media nuk kishte raportuar saktë kur kishte deklaruar se vajza juaj ishte në gjendje të mirë shëndetësore dhe kishte dalë nga spitali.

Ndaj kërkohej monitorimi i rastit dhe marrjen e masave administrative ndaj televizionit përkishtetës; detyrimin e medias për të përgënjeshtuar lajmin dhe për të kërkuar ndjesë publike; mbrojtjen e dinjitetit të fëmijës tuaj nga dezinformimi mediatik.

2. Administrimi i Ankesës

Në kuadrin e administrimit të ankesës, Këshilli i Ankesave e pati të pamundur të verifikonte përmbajtjen e linkut të vendosur në dispozicion, pasi nuk hapej.

Megjithatë, nisur nga interesi më i lartë i fëmijës, Këshilli i Ankesave shkoi përtej të dhënave, që përmbante linku i sipërcituar, duke verifikuar materialin e publikuar në platformën YouTube të Top Channel, me titull “Top Channel/ Pitbulli sulmon 4-vjeçaren në Vlorë, e mitura plagoset në

kokë”, si dhe kronikën e transmetuar në edicionin informativ të orës 15:00, më datë 7 prill 2026, konkretisht materialin e transmetuar rreth orës 15:20.

Nga verifikimi rezultoi, se në materialin e publikuar në platformën YouTube, Televizioni Top Channel kishte marrë masa për mbrojtjen e identitetit të fëmijës, duke përdorur teknika të posaçme për mbulimin e pamjeve gjatë trajtimit në spital, ndërsa raportimi mbi gjendjen e saj shëndetësore paraqitet korrekt.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Për rrjedhojë, Këshilli i Ankesave nuk konstatoi shkelje të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe të Kodit të Transmetimit.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
Ankues	Report TV	Kronikë	26.05.2026

1. Objekti i Ankesës

Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) i mbërriti një ankesë me objekt transmetimin e aksidentit ndodhur në aksin “Elbasan–Librazhd”, ku humbi jetën një fëmijë 7-vjeçar. Në ankesë pretendohet se “Report TV” gjatë transmetimit të ngjarjes kishte publikuar të dhëna sensitive të fëmijës viktimë e aksidentit, shoqëruar gjithashtu me pamje shqetësuese për publikun.

2. Administrimi i Ankesës

Në kuadër të administrimit të ankesës, Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive konstatoi se gjatë raportimit mediatik të aksidentit të ndodhur në aksin Elbasan-Librazhd, konkretisht: në Edicionet Informativ, dt. 25 Maj 2026, në orën 15:00, 20:00, 23:00: - ishte publikuar fotoja dhe identiteti i fëmijës, (gjeneralitete të plota) viktimë e aksidentit rrugor, - ishin publikuar të dhëna me përshkrim mungesë ndjeshmërie për familjarët e viktimës dhe publikun, (përshkrimi reporterit, citoj: automjeti e kishte marrë zvarrë për disa metra fëmijën, etj.).

Këshilli i Ankesave, pasi shqyrtoi përmbajtjen audiovizive të raportimit mediatik, evidentoi shkelje me publikimin fotos dhe identitetit të fëmijës viktimë e aksidentit. Gjithashtu, gjatë raportimit mediatik të parë mediatik (edicioni ora 11:00) ishin publikuar njollat e gjakut në rrugë pa mbulimin e posaçëm teknik, teksa në kronikishtet në vijim komentet e gazetari në lidhje me ngjarjen përfshijnë përshkrime që tejkshtelojnë interesin publik, por detaje më shumë sensacionale.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli vlerësoi se raportimi mediatik i mësipërm përbënte shkelje të Ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, konkretisht:

- Neni 4, “Parimet themelore të transmetimeve audiovizive”, pikishte 1/b, “Kjo veprimtari respekton në mënyrë të veçantë të drejtat, interesat dhe kërkesat morale e ligjore për mbrojtjen e fëmijëve”.
- Neni 33, pikishte 1/ç (“të mos cenojë dinjitetin dhe të drejtat themelore të njeriut”) dhe pikishte 1/dh (“të mos cenojë të drejtën e fshehtësisë së jetës private të individit në çdo program të transmetuar nga OSHMA-të dhe mjetet e përdorura për të realizuar këto programe”).

Gjithashtu, konstatohet shkelje e Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin nr. 60, datë 10.07.2023, (i ndryshuar me vendimin nr. 107, datë 11.11.2024), konkretisht:

- Seksioni 3, pikishte 3,18 sipas së cilës “OSHMA-të mbajnë në konsideratë ndjeshmërinë e publikut në rastet e fatkeqësive, kishetastrofave, aksidenteve, duke u dhënë përparësi operacioneve të shpëtimit dhe mbështetjes. Media duhet të tregojë maturi me fotot, videot amatore ose pamjet e kishetastrofave, aksidenteve ose dhunës, duke respektuar dinjitetin e të ekspozuarve dhe ndjeshmërinë e të afërmeve”.

Publikimi i identitetit dhe fotos së një fëmije viktimë ishte shkelje e ligjit teksa cenonte privatësinë dhe të drejtat e të miturit, dëmtonte interesin më të lartë të fëmijës dhe mund të shkaktojë pasoja psikologjike për të dhe familjen. Ligji dhe rregullat etike të medias kërkojnë mbrojtjen e identitetit të fëmijëve në raste aksidentesh apo ngjarjesh tragjike. Në bazë të këtyre konstatimeve, Këshilli i Ankesave propozoi sanksion financiar i cili u miratua nga Bordi i AMA-s.

ANKESA JASHTË JURIDIKSIONIT

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
Gj.C	Ora News Facebook Pamfleti	Shkrim	05.01.2026

1.Objekti i Ankesës

Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) i mbërriti një ankesë me objekt një artikull të publikuar në portalin e OSHMA-së “Ora News”, Pamfleti dhe në “Facebook”.

2.Administrimi i Ankesës

Në ankesë shtetasi Gj.C pretendonte se: “Shkrimi përmban shpifje dhe fyerje të rënda, cenon dinjitetin dhe të drejtat e mia, bie ndesh me vlerësimet zyrtare “Shkëlqyeshëm” të KLP dhe shkel nenin 8 të KEDNJ, ndaj kërkoj masa administrative ndaj Ora News dhe çdo media tjetër që e kishte shpërndarë”.

3.Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në kuadrin e administrimit të ankesës, drejtuar Autoritetit të Mediave Audiovizive, ankuesit iu sqarua se:

- Në rastin konkret, cituar edhe nga OSHMA-ja “Ora News” në portalin e saj, burimi parësor ishte portali “Pamfleti”. Neni 2, i ligjit nr.97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, konkretisht nenit 2, “Fusha e zbatimit” , përcakton se “Ky ligj zbatohet për transmetimet e mediave audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare, shërbimet mbështetëse të tyre dhe platformat e shpërndarjes së videove”. Ky ligj nuk zbatohet për median e shkruar – qoftë offline apo online, artikulli i referohet portalit “Pamfletit”.

Edhe pas ndryshimeve ligjit nr. 97/2013 me ligjin nr. 30/2023, mediat online (portalet), vijojnë të mbeten jashtë juridiksionit të Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), objekti i ankesës ishte jashtë juridiksionit të Autoritetit të Mediave Audiovizive.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
S.O	Tik Tok	Video	22.01.2026

1.Objekti i Ankesës

Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive i mbërriti në shqyrtim ankesën e shtetas S.O mbërritur përmes postës elektronike (info@ama.gov.al më datë 22.01.2025) në lidhje me disa video të publikuara në platformën Tik Tok dhe Instagram. Në ankesë pretendohet se videot në fjalë u publikuan dhe shpërndarë pa pëlqimin e shtetasit B.H

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Ankuesit iu bë me dije se në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 51, datë 06.03.2025, i cili ndalon aksesin zyrtar në platformën TikTok në Republikën e Shqipërisë, Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) nuk kishte mundësi institucionale për të ndjekur apo raportuar përmbajtje të dëmshme në këtë platformë.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
D.D	Instagram		06.02.2026

1.Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) i mbërriti në shqyrtim edhe ankesë përmes postës elektronike (info@ama.gov.al më datë 06.02.2026) me objekt një faqe informuese e paraqitur në rrjetin social “Instagram”, nën emërtimin “histori_studentore_1”. Në ankesë, pretendohet se : “Shën Nënë Tereza akuzohet pa asnjë provë për trafikim fëmijësh, përfshirje në krime ndërkombëtare dhe përfitime financiare të paligjshme”.

2.Administrimi i Ankesës

Referuar ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, konkretisht Neni 30/1, i cili përcakton se “Ofruesi i shërbimit të platformave të shpërndarjes së videove ishte në juridiksionin e Republikës së Shqipërisë kur zyra apo struktura drejtuese e tij ishte në territorin e Republikës së Shqipërisë”.

Rrjetet sociale “Facebook” dhe “Instagram”, pjesë e platformës “Meta”, nuk ishin regjistruar në territorin e Shqipërisë dhe, për këtë arsye, ato nuk bien nën juridiksionin e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA).

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Bazuar në legjislacionin në fuqi, AMA nuk kishte mundësi të administrojë ankesën në këtë rast.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
Shoqeri B.O	OraNews SyriTV TV Apollon	Shkrim	11.02.2026

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) i mbërriti në shqyrtim ankesën e Shoqërisë BOLV-OIL, përfaqësuar nga administratori z. A. B, dorëzuar në (AMA) në datën 11.02.2026 me nr.prot 609 dhe me objekt një shkrim/lajm të publikuar në televizion OraNews/SyriTV/TV Apollon.

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave pasi administroi ankesën e shtetasit A. B me nr prot 609 ju informon se ankesa ishte jashtë juridiksionit të Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) pasi legjislacioni në fuqi, ligji nr 97/2013, : “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar dhe Kodi i Transmetimit nuk na lejojnë të trajtojmë çështje që kishenë të bëjnë me platformat dhe për mungesë të përfaqësuesve ligjore në vendin tonë. Jashtë juridiksioni, neni 2 + plotësim te dhënave të ankesave.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
K. R	Vizion Plus		04.03.2026

1.Objekti i Ankesës

Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) i mbërriti në shqyrtim ankesën e shtetasit K.R mbërritur në institucionin tonë përmes postës elektronike (info@ama.gov.al, më datë 20.04.2026), me objekt një video të publikuar në platformën YouTube.

2.Administrimi i Ankesës

Në ankesë, shtetasi K.R pretendonte se: “Kishte ngarkuar në YouTube një video në adoleshencë që përmban cenim të privatësisë dhe gjithashtu nuk kishte akses prej shumë vitesh”.

Në kuadër të administrimit të ankesës , ju bë me dije se:

- Neni 2 i ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, konkretisht neni 2 “Fusha e zbatimit”, përcakton se: “Ky ligj zbatohet për transmetimet e mediave audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare, shërbimet mbështetëse të tyre dhe platformat e shpërndarjes së videove”.
- Edhe pas ndryshimeve të ligjit nr. 97/2013 me ligjin nr. 30/2023, komunikimi me platformat e shpërndarjes së videove vijon të mbetet jashtë juridiksionit efektiv të Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), për shkak të mungesës së përfaqësimit të tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë. Kjo nënkupton se Autoriteti nuk mund t’u imponohet platformave përmes vendimmarrjes së tij.

3.Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në kushtet e mungesës së juridiksionit, vendimmarrja mbi përmbajtjet u mbetet vetë platformave. Nga përvoja e deritanishme e komunikimit me platformat, nëpërmjet kishtenaleve të dedikuara të Autoritetit, ju informojmë se platforma YouTube nuk heq përmbajtje që nuk përmbajnë elementë të dukshëm të dëmshëm për ndjekësit e saj në nivel global.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
E.B	Gazeta Impakt		09.03.2026

1.Objekti i Ankesës

Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) i mbërriti në shqyrtim ankesën e shtetasit E.B, mbërritur në institucionin tonë përmes postës elektronike (info@ama.gov.al, më datë 09.03.2026), me objekt një artikull të publikuar në gazetën “Impakt”.

Në ankesë kërkohej “*fshirjen e një artikulli që përmban një sulm denigrues, fyerje dhe shpifje. Ky lloj shkrimi fsheh pas tij një ngarkesë ideologjike që nxit urrejtjen dhe ndasitë në shoqëri*”, duke iu referuar artikullit të publikuar online.

2.Administrimi i Ankesës

Në kuadër të administrimit të ankesës ju bë me dije se:

- Së pari, Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), si autoritet rregullator në fushën e shërbimeve të transmetimeve audiovizive, ushtron kompetencat e tij në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Në përputhje me nenin 2 “Fusha e zbatimit” të këtij ligji, ai zbatohet për transmetimet e mediave audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre. Përmbajtjet e publikuara në mediat online dhe portalet nuk përfshihen në këtë fushë rregullimi dhe, për rrjedhojë, nuk bien në juridiksionin e Autoritetit të Mediave Audiovizive, siç ishte rasti i artikullit të publikuar në gazetën online “Impakt”.

Edhe pas ndryshimeve të fundit të ligjit nr. 97/2013, të miratuara me ligjin nr. 30/2023 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 97/2013 ‘Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë’”, mediat online vijnë të mbeten jashtë objektit të veprimtarisë rregullatore të Autoritetit të Mediave Audiovizive.

3.Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Për sa më sipër, për trajtimin e çështjes së ngritur nga ana e ankuesit iu rekomandua mund t’i drejtohej burimit parësor të publikimit të artikullit, konkretisht gazetës “Impakt”, ose të ndiqni rrugët e tjera ligjore që parashikon legjislacioni në fuqi.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
A.M	Media		17.03.2026

1.Objekti i Ankesës

Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) i mbërriti për shqyrtim ankesa e shtetasit A.M, të paraqitur përmes postës elektronike (info@ama.gov.al) më datë 13.03.2026, me objekt: “Një material i shpërndarë në media”, ku pretendohet: “Personi në fjalë nuk jam unë, por tjetër person”. “Në vitin 2006 kishte qenë 18 vjeç dhe me studime në Itali” “Nuk kishte qenë asnjëherë i dënuar” “Nuk kishte qenë asnjëherë anëtar Këshilli dhe nuk jam anëtar Këshilli”.

2.Administrimi i Ankesës

Pas verifikimit parapak të ankesës, më datë 18.03.2026 Këshilli i Ankesave i kërkoi të plotësonte elementët e domosdoshëm të ankesës (datën, orën dhe median ku ishte transmetuar materiali audioviziv), për të bërë të mundur administrimin e saj.

3.Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pas përgjigjes së shtetasit A.M më datë 18 mars 2026, ku vendosi në dispozicion datat dhe mediat, ku ishte publikuar lajmi, për të cilin ankohej, Këshilli i Ankesave ndërmori verifikimin e të dhënave, duke konstatuar, se lajmi i referuar prej tij, nuk ishte transmetuar në mediat audiovizive, por ishte publikuar si artikull në mediat online.

Lidhur me sa më sipër, ju bë me dije se Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) nuk kishte juridiksion mbi mediat online. Referuar ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, konkretisht nenit 2, “Fusha e zbatimit”, “Ky ligj zbatohet për transmetimet e mediave audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre”. Mediat online (portalet) ishin jashtë juridiksionit apo/dhe kompetencave të Autoritetit të Mediave Audiovizive.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
A.N	Syri TV	Piranjat	17, 25.03.2026

1.Objekti i Ankesës

A.N kërkonte vënien në dispozicion të praktikës së plotë administrative dhe sqarimin e kronologjisë procedurale dhe verifikimin e zbatimit efektiv të masave të marra lidhur me materialet audiovizive objekt ankese, përfshirë vlerësimin e masave shtesë administrative dhe/ose sanksioneve në rast moszbatimi” dhe pretendimin, se “deri më datë 19.05.2026 materialet audiovizive objekt ankese nuk rezultojnë të jenë hequr në mënyrë efektive nga subjektet përgjegjëse”.

2.Administrimi i Ankesës

Këshilli i Ankesave kishte shqyrtuar ankesat e shtetases A.N nr. 901, prot., datë 17.03.2026, nr. 901/1, prot., datë 25.03.2026 dhe ankesën shtesë nr. 901/2, prot., datë 31.03.2026, nëpërmjet të cilave pretendohet cenimi i privatësisë, dinjitetit dhe përpunimi i paligjshëm i të dhënave personale dhe sensitive në përmbajtjet audiovizive të transmetuara në “Syri TV” dhe të publikuara në llogaritë e tij online. Në përfundim të shqyrtimit administrativ, subjektit audioviziv “Syri TV” i ishte komunikuar masa paralajmëruese “Tërheqje vëmendjeje” nëpërmjet postës elektronike më datë 31.03.2026, së bashku me rekomandimin për editimin e përmbajtjeve audiovizive objekt ankese. Lidhur me këtë, Ju jeni informuar nga Këshilli i Ankesave përmes postës elektronike, si edhe me shkresën nr. 902/3, prot., datë 21.04.2026. Për kronologjinë e procedurave të ndjekura dhe hapat e ndërmarrë, Ju jeni vënë në dijeni nëpërmjet komunikimeve të sipërpërmendura, përfshirë rekomandimin e Këshillit të Ankesave për editimin e materialeve audiovizive në përputhje me standardet e parashikuara nga ligji nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Kodi i Transmetimit. Në vijim të kërkesës (nr. 1390, prot., datë 19.05.2026), Këshilli i Ankesave kishte vijuar komunikimin me OSHMA-në në formën e një rikujtese, me qëllim nxitjen e reflektimit në drejtim të zbatimit të rekomandimeve të adresuara, në funksion të mbrojtjes së privatësisë, dinjitetit, të dhënave personale dhe interesit më të lartë të fëmijës. Aktualisht, Këshilli i Ankesave ishte në pritje të përgjigjes së subjektit lidhur me këtë komunikim.

3.Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Për sa më sipër, pavarësisht se Këshilli i Ankesave do të vazhdojë të nxisë subjektin të reagojë dhe aktualisht ndodhet në pritje të përgjigjes së tij lidhur me komunikimin e fundit, ai e kishte të pamundur t’i imponohet medias në lidhje me materiale të publikuara në platforma të shpërndarjes së videove që ndodhen jashtë juridiksionit të Republikës së Shqipërisë, apo të aplikojë sanksione ndaj saj për mosheqjen e tyre.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
L.B	Andale YoTube		30.03.2026

1.Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive i mbërriti për shqyrtim ankesat e shtetasit L.B.

2.Administrimi i Ankesës

Në kuadër të administrimit të ankesave, ankuesve ju bë me dije sa më poshtë vijon:

1. në lidhje me ankesën ardhur me datë 17.03.2025, me objekt “Përmbajtje të papërshtatshme, sjellje të dhunshme, rrezik për fëmijët, kërcenim për sigurinë etj
2. po kështu edhe ankesa ardhur me datë 04.03.2025, me objekt “Përmbajtje të dëmshme për fëmijët, rrezik për të gjithë grupmoshat, gjuhë ofenduese, fjalor denigrues, degjenerim total”
3. nga verifikimet (në lidhje me ankesën 1-2) rezulton se materialet e referuara prej jush ishin publikuar në kishtenalin e shpërndarjes së videove “You Tube”, përkishtësisht me datë 13 Tetor 2014 dhe 20 Maj 2022.

Bazuar në ligjin nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar neni 2 i ligjit i jep AMA-s si autoritet rregullator kompetencë edhe mbi veprimtarinë audiovizive të OSHMA-ve dhe/ose të PSV-ve. Në kushtet e mungesës së një përfaqësimi dhe regjistrimi të platformës You Tube në Republikën e Shqipërisë, Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) nuk kishte juridiksion mbi të.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në kushtet e mungesës së një përfaqësimi dhe regjistrimi të platformës You Tube në Republikën e Shqipërisë, Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) nuk kishte juridiksion mbi të. Gjithashtu, Këshilli i Ankesave i bëri me dije se datat e materialeve të mësipërme, të referuara prej ankuesit ishin jashtë afateve ligjore të parashikuara nga legjislacioni në fuqi. Rrjeti social “Instagram”, pjesë e platformës “Meta” nuk kishte regjistrim në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe për pasojë ishte jashtë juridiksionit të autoritetit të Mediave Audiovizive.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
G.Sh	Facebook		14.04.2026

1.Objekti i Ankesës

Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) i mbërriti për shqyrtim ankesën e shtetasit G.Sh mbërritur në institucionin përmes postës elektronike (info@ama.gov.al, më datë 14.04.2026), me objekt një video të publikuar në rrjetet sociale. Në ankesë, shtetasi Sh pretendonte se: “Një video që ishte bërë nga unë ishte shpërndarë gjerësisht në rrjetet sociale; ju lutem, nëse mund të bëni diçkishte për ta mbyllur”.

2.Administrimi i Ankesës

Në kuadër të administrimit të ankesës , ju bë me dije se:

- Linku që keni vendosur në dispozicion nuk hapet, çkishte e bën të pamundur verifikimin e përmbajtjes së referuar.
- Neni 2 i ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, konkretisht neni 2 “Fusha e zbatimit”, përcakton se ky ligj zbatohet për transmetimet e mediave audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare, shërbimet mbështetëse të tyre dhe platformat e shpërndarjes së videove.
- Megjithatë, edhe pas ndryshimeve të ligjit nr. 97/2013 me ligjin nr. 30/2023, komunikimi me platformat e shpërndarjes së videove vijon të mbetet jashtë juridiksionit efektiv të Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), për shkak të mungesës së përfaqësimit të tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë, çkishte nënkupton se Autoriteti nuk mund t’u imponohet platformave përmes vendimmarrjes së tij. Në këto kushte, vendimmarrja mbi përmbajtjet u mbetet vetë platformave.

3.Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Shtetasit G.Sh ju bë me dije se objekti i ankesës ishte jashtë juridiksionit.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
H.M	TV Klan	Stop	17.04.2026

1.Objekti i Ankesës

Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive i mbërriti për shqyrtim ankesa e shtetasit H.M nr.1127 prot., datë 17.04.2026, me objekt “*emisionin investigativ “Stop”, transmetuar në televizionin Klan*” më datë 07.04.2026.

2.Administrimi i Ankesës

Në kuadër të administrimit të ankesës, ju bë me dije sa më poshtë vijon:

- Emisioni investigativ “Stop” transmetuar në datën 01.10.2025, kishte qenë pjesë e një procedure të mëparshme ankimi dhe Ju jeni njoftuar për vendimmarrjen e marrë nga Këshilli i Ankesave, strukturë pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive.
- Në lidhje me pretendimet, sa i takon emisionit investigativ “Stop”, transmetuar më datë 16.02.2026, Ju bë me dije se ky emision rezulton jashtë afatit 30 ditor të parashikuar nga neni 52 i Ligjit 97/2013 për paraqitjen e ankesës. Së dyti, sipas ligjit 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, neni 2, “Fusha e veprimit”, Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) ishte autoritet rregullator në fushën e transmetimeve audiovizive lineare dhe jolineare, si dhe të shërbimeve mbështetëse të tyre.
- Bazuar në sa më sipër, kompetencat e Autoritetit lidhen me: përmbajtjen audiovizive të transmetuar; respektimin e standardeve etiko-ligjore në transmetim; monitorimin e përmbajtjes së transmetuar për përputhshmëri me ligjin organik të AMA-s dhe Kodin e Transmetimit.

3.Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në kthim përgjigje të shkresës së Autoritetit (nr.1127/1 prot., datë 27.04.2026), OSHMA-ja bën me dije se: *“Pretendimet e ankueses për “materiale të rreme” dhe “denigrim” ishin të pabazuara dhe subjekt vlerësimi gjyqësor. Ankuesja kishte nisur tashmë një proces penal ku palë të akuzuara ishin TV Klan, moderatorët e emisionit STOP dhe gazetari që kishte trajtuar rastin”*. Referuar informacioneve të dhëna nga ankuesja dhe media, ku AMA vihet në dijeni se dy palët janë në proces gjyqësor në Gjykatën e Tiranës, bazuar në ligjin nr.97/2013, Këshilli i Ankesave nuk mund të shqyrtojë përmbajtjen audiovizive, emisionin investigativ “Stop”, transmetuar në TV Klan, më datë 07.04.2026 .

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
M.B	Facebook Instagram	-	20.04.2026

1.Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) i mbërriti për shqyrtim ankesa e shtetases M.B me objekt rrjetet sociale “Facebook” dhe “Instagram”.

2.Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në kuadër të administrimit të ankesës, ju bë me dije sa më poshtë vijon:

- Neni 2 i ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, konkretisht neni 2 “Fusha e zbatimit”, përcakton se ky ligj zbatohet për transmetimet e mediave audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare, shërbimet mbështetëse të tyre dhe platformat e shpërndarjes së videove.
- Megjithatë, edhe pas ndryshimeve të ligjit nr. 97/2013 me ligjin nr. 30/2023, komunikimi me platformat e shpërndarjes së videove vijon të mbetet jashtë juridiksionit efektiv të Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), për shkak të mungesës së përfaqësuesve të tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë, çkishte nënkupton se Autoriteti nuk mund t’u imponohet platformave përmes vendimmarrjes së tij.

Në këto kushte, vendimmarrja mbi përmbajtjet u mbetet vetë platformave.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
J.T	YouTube	Video	20.04.2026

1.Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) i mbërriti në shqyrtim ankesën e shtetasit J.T mbërritur me objekt një video të publikuar në platformën YouTube. Në ankesë, shtetasi J.T pretendonte se: *“Dua të fshij një video të adoleshencës, pasi si shkak i kësaj videoje ishte bërë shkak për bullizim në shkollë”*.

2.Administrimi i Ankesës

Në kuadër të administrimit të ankesës, ju bë me dije sa më poshtë vijon:

- Neni 2 i ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, konkretisht neni 2 “Fusha e zbatimit”, përcakton se ky ligj zbatohet për transmetimet e mediave audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare, shërbimet mbështetëse të tyre dhe platformat e shpërndarjes së videove.
- Megjithatë, edhe pas ndryshimeve të këtij ligji me ligjin nr. 30/2023, komunikimi me platformat e shpërndarjes së videove vijon të mbetet jashtë juridiksionit efektiv të Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), për shkak të mungesës së përfaqësisë së tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë, çka nënkupton se Autoriteti nuk mund t’u imponohet platformave përmes vendimmarrjes së tij.

3.Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në këto kushte, vendimmarrja mbi përmbajtjet u mbetet vetë platformave. Nga përvoja e deritanishme e komunikimit me to, nëpërmjet kishtenaleve të dedikuara të Autoritetit, rezulton se platforma YouTube nuk heq përmbajtje që nuk përmbajnë elementë të dukshëm të dëmshëm për ndjekësit e saj në nivel global.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
K.R	YouTube	Video	20.04.2026

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) i mbërriti në shqyrtim ankesën se shtetasit K.R mbërritur në institucionin tonë përmes postës elektronike (info@ama.gov.al, më datë 20.04.2026), me objekt një video të publikuar në platformën YouTube. Në ankesë, ky shtetas pretendonte se: *“Kishte ngarkuar në YouTube një video në adoleshencë që përmban cenim të privatësisë dhe gjithashtu nuk kishte akses prej shumë vitesh”*.

2.Administrimi i Ankesës

Në kuadër të administrimit të ankesës, ju bë me dije sa më poshtë vijon:

- Neni 2 i ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, konkretisht neni 2 “Fusha e zbatimit”, përcakton se: “Ky ligj zbatohet për transmetimet e mediave audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare, shërbimet mbështetëse të tyre dhe platformat e shpërndarjes së videove”.
- Edhe pas ndryshimeve të ligjit nr. 97/2013 me ligjin nr. 30/2023, komunikimi me platformat e shpërndarjes së videove vijon të mbetet jashtë juridiksionit efektiv të Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), për shkak të mungesës së përfaqësisë së tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë. Kjo nënkupton se Autoriteti nuk mund t’u imponohet platformave përmes vendimmarrjes së tij.

3.Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në kushtet e mungesës së juridiksionit, vendimmarrja mbi përmbajtjet u mbetet vetë platformave. Nga përvoja e deritanishme e komunikimit me platformat, nëpërmjet kishtenaleve të dedikuara të Autoritetit, ju informojmë se platforma YouTube nuk heq përmbajtje që nuk përmbajnë elementë të dukshëm të dëmshëm për ndjekësit e saj në nivel global.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
E.B	Newsbomb Shqiptarja.com	Shkrim	22.04.2026

1.Objekti i Ankesës

Këshillit i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) i mbërriti për shqyrtim shkresa e shtetasit E.B me nr. 1165, datë 22.04.2026, me objekt: “Kërkesë për informacion”.

E.B në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të znj. S.K kërkonte konfirmimin e ekzistencës së publikimit në faqet zyrtare të gazetave online “Newsbomb” dhe “Shqiptarja.com” të artikujve të publikuar më datë 28.01.2022, me titujt:

- “Rama: S’kishte më fond për studentët që ikin jashtë shtetit dhe turp për ata që nuk kthehen! Do t’ua japim ekselentëve që rrinë në Shqipëri!” (“Shqiptarja.com”);
- “Bursat e ekselencës do të ndërpriten, Rama: Ata që kishtenë studiuar jashtë nuk ishin kthyer më, do paguajmë ata që qëndrojnë në Shqipëri!” (“Newsbomb”).

2.Administrimi i Ankesës

Në kuadër të administrimit të kërkesës për informacion, u konstatua se: Publikimet të cilave i referoheshin ankuesit nuk përbëjnë përmbajtje audiovizive, sipas nenit 1 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, i cili përcakton se “ky ligj rregullon veprimtarinë e mediave audiovizive dhe shërbimeve mbështetëse të tyre, mbi bazën e parimit të asnishinsisë teknologjike në territorin e Republikës së Shqipërisë”.

Në vijim, neni 2 “Fusha e zbatimit”, i ndryshuar me ligjin nr. 30/2023, datë 13.04.2023, përcakton se: “Ky ligj zbatohet për transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre, si dhe për shërbimet e platformave të shpërndarjes së videove. Ky ligj nuk zbatohet për median e shkruar.”

Publikimet për të cilat kërkohet informacion, konkretisht artikujt e publikuar në “Shqiptarja.com” dhe “Newsbomb”, nuk përbëjnë materiale audiovizive, por artikuj të publikuar në median online, për të cilat Autoriteti nuk kishte kompetencë ligjore.

3.Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Për rrjedhojë, AMA, në cilësinë e autoritetit rregullator, kompetencat dhe veprimtaria e së cilës përcaktohen nga dispozitat e ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e

Shqipërisë”, i ndryshuar, si edhe nga aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, nuk kishte tagër ligjor të ndërhyjë apo të verifikojë pretendime që lidhen me materiale të patransmetuara në median audiovizive në Republikën e Shqipërisë

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
A.N	Top Channel	Shkrim	26.04.2026

1.Objekti i Ankesës

Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) i mbërriti për shqyrtim ankesa e shtetasit A.N me objekt një artikull të publikuar në web-in e “Top Channel”.

2.Administrimi i Ankesës

Në kuadër të administrimit të kërkesës se shtetasit A.N evidentuam se: Publikimi në faqen e “Top Channel” nuk ishte përmbajtje audiovizive, në kuptimin e nenit 1 të ligjit nr. 97/2013 “*Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, sipas të cilit: “ky ligj rregullon veprimtarinë e mediave audiovizive dhe shërbimeve mbështetëse të tyre, mbi bazën e parimit të asnjësisë teknologjike në territorin e Republikës së Shqipërisë”. Në vijim, sipas dispozitës ligjore, neni 2 “Fusha e zbatimit” (ndryshuar me ligjin nr. 30/2023, datë 13.04.2023), përcakton se: “Ky ligj zbatohet për transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre, si dhe për shërbimet e platformave të shpërndarjes së videove. Ky ligj nuk zbatohet për median e shkruar”. Publikimi për të cilin ankoheni (konkretisht artikulli në “Top Channel”) nuk ishte material audioviziv, por artikull në median online, për të cilën Autoriteti nuk kishte kompetencë ligjore.

3.Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pavarësisht ankesës në lidhje me artikullin në faqen online të “Top Channel”, Këshilli i Ankesave verifikoi edhe përmbajtjen audiovizive përkishtetëse, të transmetuar në edicionet informative të së njëjtës datë në “Top Channel”, nga ku rezultoi se përmbajtja audiovizive ishte në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 97/2013 “*Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, si edhe me Kodin e Transmetimit.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
D.T			15.05.2026

1. Objekti i Ankesës

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) i mbërriti për shqyrtim kërkesën e shtetasit D.T për informacion lidhur me kompetencat dhe procedurat që mund të ndiqen në rastet e publikimit online të përmbajtjeve që pretendohet se cenojnë privatësinë, reputacionin dhe dinjitetin e individit.

2. Administrimi i Ankesës

Në lidhje me kërkesën e shtetasit D.T ju sqarua se fusha e kompetencës së AMA-s përcaktohet nga ligji nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 2 i të cilit përcakton se: “Ky ligj zbatohet për transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre, si dhe për shërbimet e platformave të shpërndarjes së videove. Ky ligj nuk zbatohet për median e shkruar.”

Në rastin e referuar prej shtetasit D.T i cili – nga sa parashtrohet në kërkesë – u referohet publikimeve në një portal online, në kuptim të ligjit nr. 97/2013, AMA nuk ushtron kompetenca të drejtpërdrejta rregullatore apo administrative.

3.Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Për rrjedhojë, çdo pretendim që lidhej me cenimin e reputacionit, privatësisë, të dhënave personale apo publikimin e pretendimeve të paverifikuara me natyrë kriminale, mund të ndiqet pranë institucioneve të tjera përgjegjëse, përfshirë Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si edhe në rrugë gjyqësore sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
L.Gj	Tinder	Profil	03.06.2026

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive i mbërriti në shqyrtim ankesën e shtetas L.Gj në të cilën pretendonte për vjedhje identiteti dhe përdorimi i të dhënave (fotografi) në platformën “Tinder”. Ndaj kërkonte nga Autoriteti i Mediave Audiovizive marrjen e masave përkatëse.

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Ankuesit ju bë me dije fusha e veprimit të AMA-s:

- Së pari, Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), si autoritet rregullator në fushën e shërbimeve të transmetimeve audiovizive, vepron në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 97/2013.
- Bazuar në dispozitat e ligjit Nr.97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 2 “Fusha e zbatimit”, përcakton se “Ky ligj zbatohet për transmetimet e mediave audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre”. Platforma “Tinder” ishte jashtë juridiksionit të Autoritetit të Mediave Audiovizive.

Në vijim ju rekomandu t’i drejtohej Drejtorisë për Hetimin e Krimit Kibernetik në Policinë e Shtetit.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
E.O	JOQ	Video	15.06.2026

1. Objekti i Ankesës

Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive i mbërriti për shqyrtim ankesa e shtetasit E.O me objekt një video e publikuar nga JOQ, me një përshkrim që krijon perceptim negativ dhe të njëanshëm ndaj një infermieri në krye të detyrës.

2.Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në kuadrin e administrimit të ankesës, ankuesit ju bë me dije se:

- Sipas ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, konkretisht nenit 2 “Fusha e zbatimit”, ky ligj zbatohet për transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre, si dhe për shërbimet e platformave të shpërndarjes së videove. Ky ligj nuk zbatohet për median e shkruar.
- Përmbajtja objekt ankese rezulton të jetë publikuar në një portal informativ online dhe në rrjete sociale. Për rrjedhojë, pretendimet e ngritura në ankesën Tuaj nuk përfshihen në fushën e kompetencës së Autoritetit të Mediave Audiovizive dhe nuk mund të jenë objekt shqyrtimi administrativ nga ky institucion.
- Edhe pas ndryshimeve të fundit, të miratuara me ligjin nr. 30/2023 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 97/2013”, portalet informative online vijnë të mos përfshihen në juridiksionin rregullator të AMA-s.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
M.Y	Top-Channel (web)		22.06.2026

1. Objekti i Ankesës

M. Y i nisi Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) një ankesë ku pretendohet se në portalin e “Top Channel”, ishin publikuar të dhënat personale (*emër dhe mbiemër*), në kundërshtim me ligjin nr.124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”. Gjithashtu, si pasojë e publikimit fillestar nga Top Channel, të dhënat personale ishin ripublikuar edhe nga portale të tjera informative, duke shtuar dëmin e shkishtëktuar privatësisë.

2.Administrimi i Ankesës

Shtetasit M.Y, ju bë me dije se Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), si autoritet rregullator në fushën e shërbimeve të transmetimeve audiovizive, vepron në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 97/2013.

Bazuar në dispozitat e ligjit Nr.97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 2 “Fusha e zbatimit”, përcakton se “Ky ligj zbatohet për transmetimet e mediave

audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre”. Mediat online dhe portalet ishin jashtë juridiksionit të Autoritetit të Mediave Audiovizive, në rastin konkret, faqja online e “Top Channel”.

3.Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Dëshirojmë t’ju bë se edhe pas ndryshimeve të fundit, të Prillit 2023, konkretisht me ligjin 30/2023 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin 97/2013 “Për mediat audiovizive në republikën e Shqipërisë”, mediat online, vijnë të mbeten jashtë objektivit të veprimtarisë së Autoritetit. Në vijim ju sqarojmë se këto kompetenca i njeh ligjvënësi Autoritetit të Mediave Audiovizive. Ankuesit ju rekomandua t’i drejtohet burimit parësor të publikimit të artikullit, webit “Top Channel”.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
J.K	Facebook		22.06.2026

1.Objekti i Ankesës

Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) i mbërriti për shqyrtim ankesa e shtetasit J.K, me objekt publikimin pa autorizim të materiali filmik i publikuar në faqen “Lushnja Info” në Facebook.

2.Administrimi i Ankesës

Në kuadër të administrimit të ankesës së shtetasit J.K, Këshilli i Ankesave shqyrtoi pretendimin lidhur me përdorimin e këtij materiali nga faqja “Lushnja Info” në Facebook.

Pas shqyrtimit të rastit, ju bë me dije se objekti i ankesës së J.K, megjithëse ngre një pretendim të ligjshëm, ndodhet jashtë juridiksionit të Autoritetit të Mediave Audiovizive për sa i përket ndërhyrjes administrative në rastin konkret.

Neni 2 i ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar me ligjin nr. 30/2023, kishte zgjeruar fushën e zbatimit të ligjit edhe mbi platformat e shpërndarjes së videove. Megjithatë, ushtrimi i kompetencave të Autoritetit ndaj këtyre platformave lidhet me ekzistencën e përfaqësimit të tyre ligjor në territorin e Republikës së Shqipërisë.

3.Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në rastin konkret, platforma Meta, nëpërmjet së cilës ofrohen shërbimet Facebook dhe Instagram, nuk kishte një përfaqësues ligjor në Republikën e Shqipërisë. Për rrjedhojë, Autoriteti i Mediave Audiovizive nuk disponon kompetencën ligjore për të ndërmarrë masa administrative lidhur me përmbajtjen objekt të ankesës.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
Q.A			26.03.2026

1.Objekti i Ankesës

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) i mbërriti për shqyrtim kërkesa me objekt: shqetësimin mbi transmetimin e reklamave të suplementeve ushqimore në mediat audiovizive dhe ndikimin e tyre të mundshëm në shëndetin dhe interesat e konsumatorëve, ku pretendoni, se – në mediat audiovizive transmetohen në mënyrë të gjerë reklama për suplemente ushqimore, të cilat paraqiten si produkte me efekte shëndetësore apo kurative; – këto reklama, sipas vlerësimit Tuaj, përmbajnë pretendime që mund të jenë mashtruese ose të pabazuara shkencërisht dhe mund të ndikojnë në mënyrë të gabuar te konsumatori; dhe kërkon – ndërhyrjen e institucioneve përgjegjëse për ndalimin ose kufizimin e transmetimit të këtyre reklamave deri në verifikimin e plotë të tyre.

2.Administrimi i Ankesës

Në kuadrin e administrimit të kërkesës , ju bë me dije, sa më poshtë vijon: Sipas Rregullores së Përgjithshme të Ligjit të BE-së për Ushqimin (KE) Nr. 178/2002, shtesat ushqimore (suplementet) konsiderohen si produkte ushqimore. Përgjegjësia për sigurinë e këtyre produkteve varet nga operatori i biznesit të ushqimit që vendos produktin në treg. Për rrjedhojë, ato bien në juridiksionin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (AKU) dhe Ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008 “Për ushqimin”, i ndryshuar,

3.Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Përputhur me sa më sipër, vlerësimi lidhur me përbërjen, efektet, pretendimet shëndetësore dhe përputhshmërinë e produkteve me standardet ligjore dhe shkencore ishte kompetencë e drejtpërdrejtë e AKU-së. Autoriteti i Mediave Audiovizive, në ushtrimin e funksioneve të tij, monitoron përmbajtjet audiovizive, përfshirë komunikimet tregtare, në aspektin e respektimit të standardeve ligjore dhe etike të transmetimit.

ANKESA JASHTË AFATI

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
M.N	Media të ndryshme		01.01.2026

1.Objekti i Ankesës

Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) i mbërriti për shqyrtim ankesë lidhur me disa deklarata të bëra nga shtetasi. O. J në dalje të ndryshme televizive, të cilat pretendohet se përbënin shkelje të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Kodit të Transmetimit dhe standardeve etike.

2.Administrimi i Ankesës

Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, ju bë me dije se ajo rezultonte jashtë afatit ligjor për t’u trajtuar nga Këshilli i Ankesave, pasi në përputhje me nenin 52, pikishte 2, të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përcaktohet se:

- *“Ankesa duhet të paraqitet në formë të shkruar në Këshillin e Ankesave brenda 30 ditëve nga data e transmetimit, ose, në rastin e dy ose më shumë transmetimeve të lidhura me njëra-tjetrën, nga data e transmetimit më të vonë.”*

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Nga verifikimi paraprak i referencave të paraqitura rezultoi se përmbajtjet audiovizive për të cilat ankohej (referuar datës së dërgimit të ankesës) ishin transmetuar më herët se 30 ditë. Për rrjedhojë, ankesa nuk plotësonte kushtin procedural të afatit ligjor për marrjen në shqyrtim. Në këto kushte, Këshilli i Ankesave nuk mund të hapë procedurë verifikimi në kuadër të kompetencave të përcaktuara nga ligji nr. 97/2013.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
A.S	Web Youtube		19.06.2026

1. Objekti i Ankesës

Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) i mbërriti për shqyrtim ankesë e shtetases A.S, me objekt publikime të bëra nga disa media audiovizive për të afërmin e saj. Ankuesja pretendonte se artikulli *“përmbajnë informacione të pasakta, të ekzagjeruar dhe në disa raste të pavërteta dhe se këto publikime kishtenë cenuar rëndë dinjitetin, reputacionin dhe privatësinë e tij”*.

Ndaj kërkoi nga Autoriteti i Mediave Audiovizive:

- *Shqyrtimin e këtij rasti.*
- *Verifikimin e përmbajtjeve të publikuara nga mediat përkishtetëse.*
- *Marrjen e masave sipas ligjit në rast se konstatohen shkelje të etikës dhe legjislacionit mediatik.*

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në kuadër të administrimit të ankesës së shtetases A.S, Këshilli i Ankesave shqyrtoi linqet e nisura prej saj. Referuar Ligjit Nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, konkretisht nenit 52, “Shqyrtimi i ankesave”, “Ankesa duhet të paraqitet në formë të shkruar në Këshillin e Ankesave brenda 30 ditëve nga data e transmetimit, ose në rastin e dy ose më shumë transmetimeve të lidhura me njëri-tjetrin, nga data e transmetimit më të vonë”. Bazuar në dispozitën ligjore të sipërcituar përmbajtjet audiovizive, ta cilave Ju i referoheni nuk mund të jenë objekt shqyrtimi, pasi ishin jashtë afateve ligjore të parashikuara.

ANKESA TË NDRYSHME

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
V.K			12.01.2026

1. Objekti i Ankesës

Në përgjigje të kërkesës se shtetasit V.K për informacion dhe vënie në dispozicion të dokumentacionit, në adresë të Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), ju vu në dispozicion.

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Lidhur me kërkesën për vënie në dispozicion të “udhëzimeve apo akteve mbi masat për transparencën financiare të reklamave politike në rrjetet sociale gjatë fushatës zgjedhore”, ju sqaru se:

- Reklama politike në ligjin nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, rregullohet prej nenit 41, “Reklamat dhe shitjet e drejtpërdrejta” /pikishte 2, i cili, duke iu referuar veprimtarisë audiovizive standarde, sanksionon, se “operatori i shërbimit mediatik audioviziv (OSHMA) nuk lejohet të transmetojë reklama me qëllime politike...” dhe nenit 39, “Reklama politike”, i cili përcakton rastet kur një reklamë konsiderohet politike, bazuar në ndikimin (neni 39, pikishte 1) ose porositësit e saj (neni 39, pikishte 2).
- Në të njëjtën dispozitë theksohet qartazi, se gjatë periudhës zgjedhore, transmetimi i reklamave politike bëhet sipas ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000, “Për partitë politike”, i ndryshuar (neni 39, pikishte 3).
- Veprimtaria e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) gjatë fushatës zgjedhore zhvillohet në zbatim të nenit 39, pikishte 3, të ligjit organik nr. 97/2013, si dhe të neneve 77–85 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, dhe dispozitave të vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 2, datë 30.01.2021, “Mbi metodologjinë e monitorimit të medias audio dhe audiovizive”.
- Bazuar në këtë logjikë ligjore, edhe “Udhërrëfyti i Strategjisë Kombëtare kundër Ndërhyrjeve të Huaja dhe Dezinformimit 2025–2030” (Objektivi I, Fusha 1.3, pikishte 1.3.2, “Rregullime për transparencën financiare të reklamave politike në rrjetet sociale gjatë fushatës zgjedhore”), e përcakton AMA-n si institucionin e tretë përgjegjës, pas Ministrisë së Drejtësisë dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Kjo për shkak se, gjatë fushatave zgjedhore, roli i AMA-s, në zbatim të metodologjisë së monitorimit të hartuar nga KQZ bazuar në kërkesat e Kodit Zgjedhor, ishte monitorues dhe pasqyrues, ndërkohë që kompetenca vendimmarrëse në këtë fushë i takon KQZ-së.
- Edhe në kuadrin e detyrimeve të parashikuara në Udhërrëfyti, rregullimet e synuara – për sa kohë që lidhen drejtpërdrejt me proceset zgjedhore – do të prekin ligjin organik dhe veprimtarinë e AMA-s vetëm pasi të jenë reflektuar fillimisht në Kodin Zgjedhor.

Aktualisht, AMA mban në monitorim të përhershëm 24 operatorë të shërbimit të medias audiovizive (OSHMA), ndërkohë që 29 OSHMA të tjera monitorohen me përzgjedhje javore. Listat përkishtetëse i dërgohen paraprakisht KQZ-së, e cila, nëse e sheh të arsyeshme dhe bazuar në ankesat e marra, mund të bëjë ndryshime, përfshirë zëvendësimin e një kishtenali me një tjetër.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
E.Sh përfaqëson E.K	Report TV	Pa Gjurmë	9 -12.01.2026

1. Objekti i Ankesës

Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) i mbërriti për shqyrtim ankesa e avokates E.Sh e cila përfaqëson shtetasen E.K. Ankesa pretendohet për publikim nga emisioni “Pa Gjurmë” në televizionin “Report TV” të dhënave personale dhe mosmarrëveshjet familjare që klientja e saj E.K kishte pasur me ish-bashkëshortin N.K.

2. Administrimi i Ankesës

Pas ankesës së avokishtetes Eriselda Shpata, Këshilli i Ankesave i kërkoi emisionit “Pa Gjurmë” në Report tv paraqitje pretendimesh dhe në datën 02.02.2026 drejtuesja e programit Odeta Dume ktheu përgjigje me shkresën me nr prot 252/1.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pas shqyrtimit të plotë të materialit audioviziv të transmetuar në emisionin “Pa Gjurmë” në Report tv në datat 22 dhe 23 dhjetor të vitit 2025, Këshilli i Ankesave konstatoi se: Pati publikim të të dhënave personale pa pëlqimin znj K. Nxjerrje në publik i të dhënave sensitive për shëndetin e znj K. Si dhe u lejuan të ftuarit në studio të fyenin znj Keçe pa pasur asnjë ndërhyrje nga ana e drejtueses së programit znj Odeta Dume.

Ndërkohë juristja në studio mbajti një qëndrim pozitiv dhe konstruktiv për zgjidhjen e konfliktit duke ftuar ish-bashkëshortin dhe ish-vjehrrin e ankueses E.K, të mos zbulonin të dhëna sensitive dhe personale për zonjën K, si dhe u sugjeroi atyre që në çdo rast të ndiqnin rrugët ligjore për zgjidhjen e konfliktit.

Nga sa më sipër, Këshilli i Ankesave ju tërheq vëmendjen për shmangiet dhe njëkohësisht kërkon:

- heqjen e videos së emisionit të publikuar në platformën youtube;
- bllokimin e ritransmetimit të materialit pa reflektimin e masave të sipërpërmendura;
- raportimin e zbatimit të këtyre masave brenda një afati ligjor prej 30 ditësh.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
D.V	TV Klan	Shihemi në gjyq	11.01.2026

1. Objekti i Ankesës

Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) i mbërriti për shqyrtim ankesë lidhur me emisionin “E Diela Shqiptare / Shihemi në Gjyq”, transmetuar në TV Klan, më datë 28.01.2026.

2. Administrimi i Ankesës

Në kuadër të administrimit të ankesës, AMA i kërkoi subjektit transmetues paraqitjen e pretendimeve dhe qëndrimit të tij. Në përgjigjen e TV Klan (dt. 27.01.2026) theksohet se *“historia e transmetuar ishte paraqitur nga nëna e fëmijës, e cila mban përgjegjësi për deklaratimet e saj”*, por në të njëjtën kohë kishte vlerësuar kërkesën tuaj, duke premtuar *“mbulimin me sinjal akustik të pjesëve të pretenduara”*.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në këtë kuadër, rezultoi se ofruesi i shërbimit mediatik audioviziv i kishte marrë në konsideratë pretendimet tuaja dhe kishte reflektuar mbi to, duke paralajmëruar masa konkrete për të kufizuar elementet e pretenduara si cenuese, në përputhje me detyrimet që burojnë nga ligji nr. 97/2013 *“Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, dhe nga Kodi i Transmetimit.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
AWEN	RTSH	+18	20.01.2026

1. Objekti i Ankesës

Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) i mbërriti një ankesë më datë 21.01.2026 nga AWEN. Ankuesi pretendonte se, emisioni *“+18”*, transmetuar në datë 13.01.2026 në orën 16:00 në kishenalin RTSH2 në Radio Televizionin Publik Shqiptar: *“Shpreh shqetësimin e thellë lidhur me një incident të fundit që përfshin informacion dezinformues lidhur me Ligjin e Barazisë Gjinore për publikun e gjerë”*.

2. Administrimi i Ankesës

Në kuadër të administrimit të ankesës si dhe referuar nenit 51 të ligjit nr. 97/2013 *“Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, rregullores *“Mbi procedurat për shqyrtimin e ankesave nga Këshilli i Ankesave dhe të drejtës së përgjigjes”*, si dhe udhëzimit *“Mbi procedurat e trajtimit të ankesave nga Ofruesit e Shërbimit Mediatik Audioviziv”*, Këshilli i Ankesave kërkon nga Bordi i Shqyrtimit të Ankesave pranë televizionit RTSH paraqitjen e pretendimeve lidhur me ankesën e sipërcituar.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në kuadër të administrimit të ankesës, Këshilli i Ankesave i kërkoi Bordit të Shqyrtimit të Ankesave pranë OSHMA-së *“RTSH”*, paraqitjen e pretendimeve lidhur me ankesën tuaj.

- Me shkresën nr.659/3, prot., 26.02.2026, protokolluar me tonën nr. 569/1 datë 02.03.2026, OSHMA-ja, bëri me dije se: *“Temat që lidhen me barazinë gjinore dhe kuadrin ligjor përkatës janë trajtuar në mënyrë të vazhdueshme në programe të ndryshme të RTSH-së, përfshirë edhe në episode të tjera të këtij formati, me përfshirjen e ekspertëve dhe përfaqësuesve të institucioneve përkatëse, me synimin për të ofruar informacion të plotë dhe të balancuar”*.

- Pas marrjes së ankesës dhe paraqitjes së pretendimeve të OSHMA-së, Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive, shqyrtoi përmbajtjen audiovizive, emisionin “+18”, transmetuar në 13.01.2026, në RTSH2 HD.

Nga shqyrtimi i përmbajtjes audiovizive, emisioni “+18” transmetuar në televizionin “RTSH2HD” në datën 13.01.2026 ora 11:00, Këshilli i Ankesave evidentoi se:

- Në emision trajtohet tema e barazisë gjinore, realitet apo slogan, me fokus kryesor mendimin e të rinjve, aktivistëve të drejtave të e njeriut, znj. Zhaklin Lakatari, si dhe të ftuarat në studio, znj. Miranda Rira, pedagoge, psikologe dhe znj. Lindita Pano, Koalicioni Shqiptar Pro Familjes dhe Jetës.
- Gjatë emisionit, deklaratat e znj. Rira dhe Pano, kalojnë pa moderimin e mjaftueshëm dhe të balancuar të moderatores, e cila megjithëse në respekt të lirisë së shprehjes dhe lirisë editoriale, gjithsesi përfaqëson një informacion të njëanshëm, aq më tepër për një ligj, debati mbi të cilën duhet të jetë i gjithanshëm.

Përkundrejt, pretendimeve të OSHMA-së se: “Temat që lidhen me barazinë gjinore dhe kuadrin ligjor përkatës janë trajtuar në mënyrë të vazhdueshme në programe të ndryshme të RTSH-së”, në emisionin “+18”, transmetuar në 13.01.2026, duhet të sigurojë informim objektiv dhe të paanshëm të publikut, duke paraqitur në mënyrë të saktë faktet dhe ngjarjet, si dhe duke respektuar formimin e lirë të opinionit.

Nisur nga sa më sipër, Këshilli i Ankesave konstatoi shmangie prej kërkesave të Ligjit Nr. 97/2013 “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe Kodit të Transmetimit miratuar me vendimin e AMA-s, nr.60, 10.07.20223 (amenduar me vendimin nr.107, datë 11.11.2024) dhe i tërhoqi vëmendjen me shkresën nr.3320 prot. 02.12.2024.

Përtej rastit konkret, duke ju falënderuar për besimin e treguar ndaj institucionit dhe funksionet e tij rregullatore si edhe për bashkëpunimin gjatë këtij procesi, ju sigurojmë se Autoriteti i Mediave Audiovizive do të vijojë të u shtrojnë funksionet e tyre ligjore me seriozitet, paanshmëri dhe respekt të plotë për lirinë e medias, të drejtat themelore të individit dhe kufijtë e kompetencave që i njeh ligji.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
S.K			27.01.2026

1. Objekti i Ankesës

Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) i mbërriti për shqyrtim një ankesë ku shpreheshin shqetësime lidhur me një emision televiziv që, sipas vlerësimit të shtetasit S.K, përmbante elemente dhune, normalizim të përdorimit të substancave narkotike, skena erotike dhe përmbajtje diskriminuese ndaj grave dhe vajzave.

2.Administrimi i Ankesës

Pas shqyrtimit paraprak, ju bë me dije, se materiali nuk mund të trajtohet si ankesë e plotë për shkishtek të mungesës së elementeve të domosdoshme të ankesës, pasi në të mungojnë të dhënat lidhur me:

- emisionin/ formatin audioviziv për të cilin ankoheni;
- stacionin/ kishtenalin transmetues (OSHMA);
- datën dhe orën e transmetimit të përmbajtjes konkrete, objekt ankesë.

Këto elemente ishin të nevojshme për identifikimin e saktë të përmbajtjes dhe verifikimin e saj, në kuadër të kompetencave të Këshillit të Ankesave.

3.Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Nga ana tjetër, nga përmbajtja e mesazhit tuaj, rezulton se shqetësimi lidhet me znj. O.M, e cila, sipas informacionit publik, drejton formatin “Big Brother VIP” në Kosovë. Ju bë me dije se juridiksioni i Autoritetit të Mediave Audiovizive të Republikës së Shqipërisë shtrihet vetëm mbi ofruesit e shërbimeve audio dhe audiovizive që veprojnë dhe licencohen në Republikën e Shqipërisë, sipas ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Për rrjedhojë, nëse shqetësimi lidhet me një program të prodhuar dhe/ose transmetuar në Kosovë, ai ishte jashtë juridiksionit të AMA-s në Shqipëri.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
M.K	Syri TV	Piranjat	02.02.2026

1.Objekti i Ankesës

Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) i mbërriti për shqyrtim ankesë e shtetasit M.K me objekt: *“Ankesë për hyrje të paautorizuar në institucion publik, dhunim dhe shkelje të ligjit nga ana e gazetarëve të emisionit investigativ ‘Piranjat’ në televizionin Syri TV”.*

2.Administrimi i Ankesës

Pas shqyrtimit paraprak të përmbajtjes së ankesës, ju bë me dije se objekti i saj lidhet me veprime të pretenduara të gazetarëve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre në terren dhe jo me përmbajtjen audiovizive të transmetuar.

Në përputhje me nenin 2 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, juridiksioni i Autoritetit të Mediave Audiovizive shtrihet *“transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre si dhe për shërbimet e platformave të shpërndarjes së videove”*, pra mbi përmbajtjen audiovizive të transmetuar dhe respektimin e standardeve etiko-ligjore në transmetim.

3.Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Për rrjedhojë, Këshilli i Ankesave nuk mund të vijojë me shqyrtimin e kësaj ankese në kuadër të kompetencave të përcaktuara nga ligji.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
Xh. S	Radio Tirana	Programacioni	03.02.2026

1.Objekti i Ankesës

Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) i mbërriti për shqyrtim ankesë e shtetasit Xh.S të paraqitur përmes postës elektronike, lidhur me përmbajtjen muzikore të transmetuar nga Radio Tirana, me objekt konkret praninë e muzikës së huaj në programacion.

2.Administrimi i Ankesës

Në përputhje me ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përzgjedhja e përmbajtjes programore – përfshirë repertorin muzikor – përbën kompetencë dhe përgjegjësi të drejtpërdrejtë të ofruesit të shërbimit mediatik audioviziv, në kuadër të parimit të lirisë dhe autonomisë editoriale.

3.Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Ky ligj nuk parashikon dispozita që rregullojnë përqindjen, balancimin apo orientimin kombëtar/ndërkombëtar të repertorit muzikor në transmetim, i cili organizohet sipas kishtenaleve dhe emisioneve përkishtetëse, për sa kohë që përmbajtja nuk bie ndesh me dispozitat ligjore në fuqi dhe standardet e Kodit të Transmetimit. Autoriteti i Mediave Audiovizive ushtron kompetencat e tij vetëm në rastet kur konstatohen shkelje të ligjit ose të Kodit të Transmetimit. Nga shqyrtimi paraprak i çështjes së ngritur prej jush nuk rezulton se kemi të bëjmë me një shkelje të tillë.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
S.Sh	TV Klan	Stop	03.02.2026

1.Objekti i Ankesës

Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) kishte marrë një ankesë me shkresën Nr.513, prot., datë 03.02.2026, nga shtetasi S.Sh me objekt emisionin “Stop” transmetuar në televizionin “Klan”.

Ankuesi pretendoi se: “Emisioni “Stop”, transmetuar në datë 28 janar të vitit 2026 në mbështetje të ankimimit të shtetasit G. H, kishte ngritur akuza ndaj S.Sh sikur ai kishte marrë leje legalizimi në kundërshtim me ligjin duke korruptuar zyrtarë të Agjencisë Shtetërore të Kishtedastrës pa paraqitur asnjë fakt, asnjë provë dhe pa e dëgjuar palën e akuzuar”.

Shtetasi S. SH kërkonte heqjen e videos së transmetuar në datë 28 janar 2026 në emisionin Stop në “TV Klan”.

2.Administrimi i Ankesës

Në kuadër të administrimit të ankesës si dhe referuar nenit 51 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat për shqyrtimin e ankesave nga Këshilli i Ankesave dhe të drejtës së përgjigjes”, si dhe udhëzimit “Mbi procedurat e trajtimit të ankesave nga Ofruesit e Shërbimit Mediatik Audioviziv”, Këshilli i Ankesave kërkon nga Bordi i Shqyrtimit të Ankesave pranë televizionit paraqitjen e pretendimeve lidhur me ankesën e sipërcituar.

3.Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Media ka informuar Këshillin e Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive se ka kthyer përgjigje direkte ankuesit.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
AWEN	TV Klan	Aldo Morning Show	24.03.2026

1.Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), në kuadrin e administrimit të kërkesës/ankesës, së mbërritur në adresën zyrtare të institucionit (info@ama.gov.al), lidhur me përhapjen e informacionit të rremë mbi ligjin 64/2025 ‘Për barazinë gjinore’ dhe përmbajtjen e transmetuar në emisionin “Aldo Morning Show” në TV Klan, pas verifikimit të materialit audioviziv dhe të pretendimeve të paraqitura prej subjektit, vlerëson si më poshtë:

Në thelb të ankesës qëndron pretendimi për shmangie nga standardet ligjore të informimit dhe për trajtim të pasaktë të një çështjeje me rëndësi publike, duke iu referuar dispozitave të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, si dhe standardeve të jurisprudencës evropiane dhe legjislacionit për informimin.

2.Administrimi i Ankesës

Sipas dispozitave të ligjit nr. 97/2013, veçanërisht ato që lidhen me parimet e informimit dhe programet informative (si neni 4 dhe neni 33), kishte të bënte kryesisht me detyrime, që burojnë për përmbajtjet informative në kuptimin klasik të raportimit të lajmit dhe informimit të drejtpërdrejtë të publikut.

Ndërkohë, rasti konkret, i përdorur ishte ilustrim, lidhet me një format televiziv të tipit “morning show”, i cili, nga natyra e tij, nuk përbën një program informativ në kuptimin e ngushtë të ligjit, por një format të përzier, me elementë diskutimi, opinionit dhe ndërveprimi me të ftuar, ku këta të fundit paraqesin qëndrimet e tyre mbi çështje aktuale apo me interes publik.

Nga verifikimi i kryer rezulton se në rastin konkret, diskutimi në studio nuk kishte pasur në fokus miratimin e ligjit “Për barazinë gjinore”, por ankimimin e tij në Gjyqishtetën Kushtetuese të

Republikës së Shqipërisë nga një grupim organizatash, përfshirë Koalicionin Shqiptar Pro Familjes dhe Jetës, Forumin Mysliman të Shqipërisë dhe Diasporën për Shqipërinë e Lirë. Në këtë kuadër, i ftuari në studio, përfaqësues i këtij grupimi, kishte paraqitur argumentet dhe arsyetimin, që kishtenë çuar në ndërmarrjen e kësaj nisme ligjore.

Ky kontekst e vendos diskutimin brenda kufijve të ushtrimit të lirisë së shprehjes dhe të debatit publik mbi një çështje me interes publik dhe jo në shtrembërim të qëllimshëm të ligjit nr. 64/2025 dhe as në shkelje të standardeve të sipërpërmendura të ligjit nr. 97/2013.

3.Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Gjithashtu, nga informacioni i vënë në dispozicion nga subjekti audioviziv, në përgjigje të kërkesës së Këshillit për paraqitje pretendimesh, rezulton se çështja në fjalë ishte trajtuar në mënyrë më të gjerë dhe në formate të ndryshme programore, duke përfshirë qëndrime dhe pozicione të ndryshme, çkishte dëshmon për një qasje të përgjithshme të balancuar në trajtimin e saj.

Në rastet kur diskutime të kësaj natyre kishtenë tejkishteluar kufijtë e lirisë së shprehjes dhe ishin shoqëruar me qëndrime ekstreme, diskriminuese apo në kundërshtim me standardet etike. të përcaktuara në ligjin nr. 97/2013 dhe në Kodin e Transmetimit, Autoriteti i Mediave Audiovizive kishte ndërhyrë me masa administrative përkishtetëse - përfshirë si tërheqje vëmendjeje ndaj subjekteve audiovizive, ashtu edhe sanksione financiare ndaj një ofruesi të shërbimit mediatik audioviziv kombëtar dhe një ofruesi të shërbimit mediatik audioviziv rajonal.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
F.N	MCN TV		31.03.2026

1.Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) i mbërriti për shqyrtim ankesë e shtetasit F.N, me objekt: “Një material i publikuar në televizionin MCN”.

2.Administrimi i Ankesës

Ankuesi pretendonte se:

- emisioni në fjalë kishte publikuar materiale kundër Jush, të njëanshme, të cilat kishte dëmtuar imazhin Tuaj;– gazetarët e emisionit nuk Ju kishin kontaktuar për të marrë dhe paraqitur qëndrimin Tuaj.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pas verifikimit paraprak të ankesës, Këshilli i Ankesave konstatoi se ankesa nuk përmbante elementët e nevojshëm për vijimin e shqyrtimit.

Për këtë arsye, ju kërkua të plotësoj elementët e ankesës duke përcaktuar saktësisht:

- emisionin konkret;

- median/transmetuesin;
- datën dhe orën e transmetimit të materialit audioviziv për të cilin paraqisni ankesën.

Këto të dhëna ishin të domosdoshme për të mundësuar shqyrtimin e plotë dhe të saktë të rastit.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
L.M	News 24		20.04.2026

1.Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) i mbërriti për shqyrtim ankesën e shtetas L.M të paraqitur përmes postës elektronike, me objekt:

- një intervistë të transmetuar në “News 24” dhe të publikuar edhe në rrjete sociale;
- shqetësimin i saj lidhej me përdorimin e gjuhës shqipe në transmetimet televizive.

2. Administrimi i Ankesës

Pas verifikimit paraprak të ankesës, konstatohet se ajo nuk përmban të gjithë elementët e nevojshëm për vijimin e procedurës së shqyrtimit, konkretisht: datën dhe orën e transmetimit, si dhe identifikimin e saktë të programit audioviziv objekt ankese.

3.Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Për rrjedhojë, për vijimin e shqyrtimit të kësaj pjese të ankesës, ju kërkua të plotësoheshin këto të dhëna. Në mungesë të tyre, Këshilli i Ankesave ishte në pamundësi objektive për të vijuar shqyrtimin e ankesës.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
N.K	Vizion Plus	Ferma Vip	22.04.2026

1.Objekti i Ankesës

Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) i mbërriti për shqyrtim ankesa e shtetasit N.K me objekt: “Keqtrajtimi i kishtefshëve në emisionin Ferma Vip”. Në kuadër të administrimit të ankesës shtetasi N.K pretendonte se: “Kishte mungesë të ndjeshmërisë ndaj kishtefsheve, moskujdes ndaj tyre dhe përdorim të tyre për spektakël”.

2.Administrimi i Ankesës

Këshilli i Ankesave i sugjeroi të plotësoni të gjithë elementët e ankesës. Ndërkohë Këshilli i Ankesave verifikoi linkun e vendosur në dispozicion dhe i informoi se ishte e pamundur të kontrollojë të gjithë trasmetimin e këtij programi.

3.Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Ndaj në pamundësi për të verikuar të dhënat e nisura nga ankuesi ju kërkua plotësimi i elementëve për të vijuar më tej trajtimin e tij.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
E.Y	Syri TV	Piranjat	04.05.2026

1.Objekti i Ankesës

Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive i mbërriti për shqyrtim ankesë e shtetasës E.Y. Në ankesë kërkohej ndërprerja e shpërndarjes dhe heqjes së videos që lidhet me denoncimin e saj në emisionin “Piranjat”, duke pretenduar se qarkullimi i saj në rrjetet sociale po shkakton shqetësim dhe ngarkesë psikologjike për të dhe fëmijët e saj të mitur.

2.Administrimi i Ankesës

Këshilli i Ankesave pasi administroi ankesën e shtetasës E.Y i kerkoi asaj të përcillte disa të dhëna shtesë, konkretisht:

- Datën e transmetimit të emisionit;
- Linkun ose linket e përmbajtjeve që kërkon të shqyrtohen;

Këto të dhëna ishin të nevojshme për të mundësuar verifikimin dhe shqyrtimin e ankesës në përputhje me ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
F.I	Media		05.05.2026

1.Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive i mbërriti për shqyrtim ankesën e shtetasit F.I me objekt reklama të pijeve alkoolike në televizione në orare të aksesueshme për publikun e gjerë.

2.Administrimi i Ankesës

Me qëllim trajtimin sa më të plotë të ankesës, vlerësuam bashkëpunimin e shtetasit F.I, për të na përcjellë elementët bazë të ankesës, konkretisht datën dhe orarin e transmetimit, emrin e kishtenalit televiziv, si dhe, nëse ishte e mundur, informacion nëse transmetimi i materialit reklamues ishte konstatuar në mënyrë të përsëritur.

Këto të dhëna ishin të nevojshme për të mundësuar verifikimin dhe shqyrtimin e ankesës në përputhje me ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Kodin e Transmetimit.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
Z.H	RTSH		22.05.2026

1.Objekti i Ankesës

Përfaqësues të Shtëpisë së Fëmijës “Zyber Hallulli” në Tiranë iu drejtuan Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive një lajm të publikuar nga “RTSH”. Në ankesë pretendohet se media “*këto lajme i ishin servirur publikut si fakte të provuara dhune ndaj një fëmije që qëndron në këtë institucion, në Sh.F “Z.H” në Tiranë*”.

2.Administrimi i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë (AMA) autoritetit të Mediave Audiovizive pasi verifikoi materialin audioviziv të datës 12 maj 2026 transmetuar në kishtenalin RTSH 1 HD në emisionin “Në Kohë Reale” në orën 17:35 minuta konstatoi se nuk kishte shkelje ligjore dhe se gazetaria L.R kishte bërë një raportim korrekt në program, në asnjë rast ajo nuk kishte sulmuar institucionin apo stafin e tij dhe nuk kishte ngritur asnjë akuzë.

Ndërsa sa i përket ankesës për publikimet në platformën Facebook nga ana e gazetares L.R, Këshilli i Ankesave pranë (AMA), Autoritetit të Mediave Audiovizive pavarësisht ndryshimeve të fundit ligjore e kemi të pamundur të ndërhyjmë pasi platformat nuk kishtenë një përfaqësi ligjore në territorin e Republikës së Shqipërisë.

3.Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Nga verifikimi i materialit audioviziv dhe shqyrtimi i pretendimeve të palëve, Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive konstatoi se përmbajtja nuk kishte shkelje, konform ligjit.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
A.T	Digitalb		25.05.2026

1.Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive i mbërriti për shqyrtim ankesë nga shtetasi A.T, me objekt platformën DigitAlb, konkretisht kanalin Star Channel. Sipas ankuesit OSHMA-ja transmetonte reklama me harta të Serbisë që paraqisnin Kosovën si pjesë të saj. Ndaj kërkonte monitorimin e këtyre transmetimeve dhe marrjen e masave përkishtetëse deri në bllokimin e kishtenalit.

2.Administrimi i Ankesës

Duke e falënderuar për shqetësimin e ngritur pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive dhe me qëllim trajtimin sa më të plotë të ankesës, do vlerësonim bashkëpunimin e shtetasit A.T duke na përcjellë disa të dhëna shtesë, konkretisht datën dhe orarin e transmetimit, emrin e kishtenalit, si

dhe, nëse ishte e mundur, informacion nëse transmetimi i materialit audioviziv ishte konstatuar në mënyrë të përsëritur.

Këto të dhëna ishin të nevojshme për të mundësuar verifikimin dhe shqyrtimin e ankesës në përputhje me ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Për këtë qëllim shtetasi A.T u ftua të përdorte formularin e ankesës, i cili gjendet në faqen zyrtare të Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA). Pas plotësimit të të dhënave të kërkuara, formulari mund të dërgohet në adresën elektronike: info@ama.gov.al.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
O.G	Televizione		15.06.2026

1.Objekti i Ankesës

Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive i mbërriti për shqyrtim ankesë nga shtetasi O.G, nëpërmjet së cilës ngrinte pretendime lidhur me transmetime televizive.

2.Administrimi i Ankesës

Me qëllim shqyrtimin sa më të plotë të ankesës, ankuesit iu kërkuar disa të dhëna shtesë, konkretisht datën dhe orarin e transmetimit, emrin e kishtenalit televiziv, si dhe një përshkrim më të detajuar të objektit të ankesës.

Këto të dhëna ishin të nevojshme për të mundësuar verifikimin dhe shqyrtimin e ankesës në përputhje me ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

3.Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Për këtë qëllim, iu rekomandua përdorimi i formularit të ankesës, i cili gjendet në faqen zyrtare të Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA). Pas plotësimit të të dhënave të kërkuara, formulari duhej të dërgohej në adresën elektronike: info@ama.gov.al ose me postë.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
A.Q	Abc News		22.06.2026

1.Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) i mbërriti për shqyrtim ankesë nga shtetasi A.Q ankuesi pretendonte se “Abc News kishte censuruar në mënyrë të qëllimshme protestën masive qytetare në Tiranë, të njohur si “Revolucioni i Flamingove”. Ky televizion kishte refuzuar mbulimin objektiv në terren dhe kishte transmetuar raportime të njëanshme që manipulojnë masivitetin e saj” dhe kërkoj nga Autoriteti i Mediave Audiovizive marrjen e masave në përputhje me ligjin nr.97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

2.Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Autoriteti i Mediave Audiovizive si autoritet rregullator në fushën e shërbimeve audio/audiovizive vepron në bazë të ligjit nr.97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Kodit të Transmetimit, miratuar me Vendimin e AMA-s, nr. 60, datë 10.07.2024.

Referuar dispozitës ligjore të sipërcituar, sqarojmë se përzgjedhja e ngjarjeve që mbulohen ose nuk mbulohen nga një subjekt audioviziv ishte pjesë e përgjegjësisë dhe pavarësisë editoriale të tij, ku Autoriteti nuk kishte kompetencë të ndërhyjë. Megjithatë, në përmbushje të detyrimeve që lindin nga ligji nr.97/2013, Drejtoria e Monitorimit në AMA kryen monitorim “ex officio”, prej të cilit rezulton se nga data 1 qershor dhe në vijim, mediat audiovizive kishtenë ofruar dhe ofrojnë një minutazh të lartë pasqyrimi të protestës, kundër qeverisë dhe investimit në Zvërnec - si në formën e ndjekjes së saj live ashtu edhe në formën e debateve me këtë tematikë. Media, në vëzhgimin tonë, ia kishte dalë të plotësojë të drejtën e publikut për informim, liri shprehjeje dhe pluralizëm.